



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Akademia e Drejtësisë - Akademija Pravde - Academy of Justice

---

**Programi i Trajnimit Fillestar**  
për gjyqtarët e sapoemëruar  
**2024/2025**

Ky program trajnimi është miratuar nga Këshilli Drejtues, i Akademisë së  
Drejtësisë me datën 07 dhjetor 2023



Publikuar nga Akademia e Drejtësisë

© AD 2024, Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Përmbajtja e këtij materiali mund të përdoret për qëllime edukative dhe jo-komerciale duke ju referuar AD-së si burim. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi apo çfarëdo forme tjetër e publikimit pa konfirmimin e AD-së.

Tabela e përmbajtjes

1. Hyrje.....	6
2. Synimet kryesore të programit trajnues.....	7
3. Baza ligjore.....	7
4. Metodologjia e hartimit të programit të trajnimeve.....	7
5. Struktura dhe përmbajtja e PTF.....	8
5.1 Synimi për kualifikim.....	8
5.2 Struktura e PTF.....	8
5.3 Përmbajtja e PTF.....	11
5.3.1 Pjesa e trajnimit teorik.....	11
5.3.2 Pjesa e trajnimit praktik.....	11
5.4 Program trajnimi në institucionet jo gjyqësore.....	12
5.5 Simulimet e gjykimeve.....	13
5.6 Puna hulumtuese.....	13
6. Vlerësimi.....	13
6.1 Shembull i vlerësimit nga ana e trajnuesit.....	14
6.2 Shembull i tabelës së vlerësimit nga ana e Mentorit.....	15
7. Kalendari dhe orari trajnues.....	16
8. Modulet trajnuese të PTF 2024/2025 për gjyqtarët e sapoemëruar.....	16
9.1 Rendi juridik kombëtarë dhe ndërkombëtarë.....	18
9.1.1 Drejtësia kushtetuese në raport me sistemin gjyqësor dhe prokurorial.....	18
9.1.2 Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështje penale dhe civile.....	19
9.1.4 E Drejta e Bashkimit Evropian.....	20
9.1.5 Konventa Evropiane për Lirit dhe të Drejtat e Njeriut.....	21
9.2 Kodi Penal i Republikës së Kosovës.....	21
9.2.1 Kodi Penal – Pjesa e përgjithshme.....	21
9.2.2 Kodi Penal –Pjesa e veçantë.....	22
9.2.3 Krimi Kibernetik.....	23
9.2.4 Politika ndëshkimore.....	23
9.2.5 Përgjegjësia e personave juridik.....	24
9.3 Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës.....	25
9.3.1 Procedura paraprake penale.....	25
9.3.3 Masat e veçanta hetimore.....	26
9.3.4 Parimet, Kompetenca dhe Përjashtimi i gjyqtarit në procedurën penale.....	27
9.3.4 Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurën penale.....	27
9.3.5 Palët në procedurë.....	28

9.3.6 Dëshmitarët dhe të dëmtuarit në procedurën penale .....	28
9.3.7 Shqyrtimi fillestar dhe i dytë .....	29
9.3.8 Shqyrtimi gjyqësor .....	29
9.3.9 Shpenzimet e procedurës dhe kërkesat pasurore juridike .....	30
9.3.10 Procedura sipas mjeteve juridike.....	31
9.3.11 Aktgjykimi dhe llojet e tij .....	31
9.3.12 Procedura penale e kryerësve me çrregullime mendore .....	32
9.3.13 Procedurat e veçanta sipas KPPK.....	32
9.3.14 Provat në procedurën penale .....	32
9.3.15 Procedurat alternative.....	33
9.4 E drejta civile, administrative dhe ekonomike.....	33
9.4.1 E drejta civile.....	33
9.4.2 Procedura Kontestimore - pjesa e parë .....	34
9.4.3 Procedura kontestimore - pjesa e dytë.....	34
9.4.4 Procedura jokontestimore .....	35
9.4.5 Procedura përmbartimore .....	35
9.4.6 E drejta administrative.....	36
9.4.7 E drejta e detyrimeve.....	36
9.4.8 E drejta komerciale .....	37
9.4.9 E drejta e pronësisë dhe të drejtat tjera të sendore.....	38
9.4.10 E drejta e trashëgimisë.....	38
9.4.11 E drejta e punës .....	39
9.4.12 E drejta familjare.....	39
9.5 Shkathtësitë personale dhe ndërdisiplinare .....	40
9.5.1 Ngritja e shkathtësive sociale dhe menaxhimi i stresit.....	40
9.5.2 Etika Profesionale dhe përgjegjësia disiplinore .....	41
9.5.3 Menaxhimi i rasteve dhe vlerësimi i Performancës.....	41
9.5.4 Rregullat e Komunikimit.....	42
9.5.4 Arsytimi i vendimeve gjyqësore ( në lëmin penale dhe civile).....	42
9.6 Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese.....	43
9.6.1 Kodi i Drejtësisë për të Mitur .....	43
9.6.2 Ndërmjetësimi në çështje civile .....	44
9.6.3 Zhvillimi i shkathtësive gjyqësore .....	44
9.6.4 Ligji për kundërvajtje .....	44
9.6.5 Mbrojtja nga diskriminimi.....	44
9.6.6 Dhuna në familje .....	45
10. Përfundim .....	46

## 1. Hyrje

Gjyqtarët dhe prokurorët përmbushin një rol thelbësor në shoqëri, janë mbrojtësit kryesorë të drejtave dhe lirive themelore, luajnë një rol të rëndësishëm në jetën e sistemit të drejtësisë për promovimin dhe mbrojtjen e sundimit të ligjit. Ata përfaqësojnë autoritetin gjyqësor, zbatojnë ligjin dhe sigurojnë zbatimin e tij për të garantuar bashkëjetesën harmonike dhe ekuilibrin demokratik të shoqërisë. Gjithashtu janë profesione që përfshijnë vendimmarrje në nivel të lartë përgjegjësie, detyrë që kërkon cilësi të konsiderueshme njerëzore dhe ndjenjën e rëndësisë së shtetit ligjor, si dhe aftësi të shkëlqyera dëgjimi dhe analize.

Trajnimi fillestar është një komponent thelbësor e çdo sistemi për të ofruar drejtësi cilësore, dhe faktorë kyç në garantimin e pavarësisë, paanshmërisë, kompetencës profesionale dhe etike të gjyqësorit. Akademia e Drejtësisë, në kuadër të mandati të saj, organizon trajnimin fillestar për aftësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të shtetit të sapo emëruara. Programi i Trajnimit Fillestar (PTF) për gjyqtarët të sapo emëruar ka për qëllim zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe shkathtësive praktike të gjyqtarëve dhe prokurorëve të shtetit të sapo emëruar. PTF zgjatë 12 muaj dhe struktura e tij është e ndarë në dy pjesë: trajnimi teorik i cili realizohet i kombinuar me shqyrtime të rasteve nga praktika gjyqësore, simulime dhe forma tjera ndërsa pjesa praktike realizohet në gjykata dhe prokurori ku ata janë emëruar nën mbikëqyrjen e mentorit.

Trajnimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar synon të mësojë jo vetëm ligjin, por edhe një gamë të gjerë aftësish praktike që do t'u nevojiten në jetën e tyre profesionale, të tilla si hartimi i vendimeve dhe vendimeve procedurale, aftësia për të bërë pyetje, kryesimi i seancave gjyqësore ose kryerja e veprimeve të tjera të dobishme për avancimin e një çështjeje penale ose civile.

Njohurit të cilat fitohen në trajnimin fillestar si në pjesën teorike ashtu edhe në pjesën praktike, do të jetë me kuptim të rëndësishëm në formimin profesional si gjyqtarë dhe prokuror të pavarura, të paanshme dhe efikas.

Programi për gjeneratën e dhjetë të gjyqtarëve 2024/2025 është gjithëpërfshirës duke filluar nga legjislacioni vendor dhe ndërkombëtar, hartimi i vendimeve gjyqësore bazuar në analiza të fakteve, aplikim i rregullave etike, zhvillimi i shkathtësive gjyqësore dhe sociale, zhvillimi i kapaciteteve hulumtuese, organizative dhe menaxhuese dhe zhvillimi i shkathtësive inerdisciplinare. Për zbatimin e programit do të përdoret metodologjia e bashkëbisedimit, diskutime të rasteve nga praktika gjyqësore dhe zgjedhjen e tyre nga ana e gjyqtarëve të sapoemëruar, simulime gjykimi etj.

Për zbatimin e këtij programi trajnues do të hartohen dokumente përcjellëse si: modulet trajnuese, kalendari trajnues, orari i trajnimeve dhe materialet prezantuese për temat konkrete.

Ky program trajnimi është miratuar nga Këshilli Drejtues i AD-së.

## 2. Synimet kryesore të programit trajnues

Trajnimi gjyqësor është esencial në funksionimin e një sistemi gjyqësor e prokurorial profesional. Në veçanti mjaftë i dobishëm dhe i domosdoshëm vlerësohet edhe trajnimi i gjyqtarëve të sapoemëruar apo trajnimi fillestar siç njihet në terminologjinë e trajnimit gjyqësor dhe konsiderohet si një prej faktorëve kyç në garantimin e pavarësisë, paanshmërisë dhe kompetencës profesionale e etike të gjyqësorit.

Në programin e trajnimit fillestar për vitin 2024, synimet kryesore janë:

- Ofrimi i një programi trajnimi adekuat për gjyqtarët fillestar, duke u bazuar në njohuritë ekzistuese të përfituesve;
- Krijimi i një programi trajnues që reflekton kompetencat dhe detyrat në ushtrimin e profesionit të gjyqtarit;
- Trajnuesit/mentorët të shërbejnë si lehtësues në procesin e mësim-nxënies duke e konsideruar gjykatën si një institucion edukues;
- Informimi me punën e institucioneve tjera të sistemit të drejtësisë;
- Ofrimi i mundësisë për përfituesin, që duke u angazhuar në punë ekipore, të kryejnë hulumtime për zhvillimin e tyre profesional dhe hulumtime në kontribut të zhvillimit të përgjithshëm të sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

## 3. Baza ligjore

Ligji për Akademinë e Drejtësisë, është ligj bazë për organizimin e trajnimit fillestar. Dispozita tjera që përcaktojnë dhe mbështesin trajnimin fillestar gjenden edhe në ligjet tjera të cilat e rregullojnë funksionimin e sistemit gjyqësor.

Me qëllim të zbatimit praktik të këtij programi trajnues AD, përveç koordinimit me Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nxjerrë edhe rregulla të brendshme.

Për këtë qëllim AD bazohet në:

- Ligji për Akademinë e Drejtësisë (Nr. 05/L-095)
- Ligji për Gjykatat (Ligji Nr. 06/L - 054)
- Ligji Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës
- Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (Nr. 05/L-094)
- Rregullorja për Programin e Trajnimit Fillestar Nr.03/2017
- Rregullorja Nr. 07/2017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores 03/2017 për Trajnimin Fillestar
- Plani i Punës të AD-së për vitin 2023 (i miratuar nga Këshilli Drejtues i AD-së me datë 22 nëntor 2022);

## 4. Metodologjia e hartimit të programit të trajnimeve

Për hartimin e këtij programi trajnues janë zhvilluar diskutime me përfaqësuesit kryesor të sistemit gjyqësor, me gjyqtarë, trajnues dhe gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratave të kaluar. Gjithashtu janë bërë vlerësime të raporteve të institucioneve vendore e ndërkombëtare në Kosovë si dhe janë zhvilluar një sërë mekanizmash për vlerësimin e nevojave për trajnime.

Më poshtë janë të prezantuara disa nga hapat e ndërmarrë me qëllim të hartimit të këtij programi:

- Konsultimet me Kryetarët e Gjykata Themelore
- Konsultimet me Kryesuesin dhe anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Diskutimet me trajnues të PTF;
- Pyetësorët e shpërndarë për gjyqtarëve dhe prokurorëve në PTF;
- Analizimi i strukturës ligjore në fuqi;
- Praktikrat e institucioneve ndërkombëtare të trajnimit etj.

## 5. Struktura dhe përmbajtja e PTF

### 5.1 Synimi për kualifikim

Koncepti i përgjithshëm i synimeve për kualifikim profesional të pjesëmarrësve në PTF është:

- Përbushja e kërkesave të përgjithshme për funksionin e gjyqtarit në Kosovë;
- Kompetencat (njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet) e nevojshme për performancë të suksesshme profesionale si gjyqtarë në sistemin gjyqësor në Kosovë;
- Aftësia për t'u përballur me kërkesa dhe sfida që ndryshojnë përherë;
- Aftësia për të përdorur dhe zbatuar kompetencat e kërkuara drejtpërsëdrejti në punë (profesionale, metodike, sociale dhe personale), theks në kompetenca sociale dhe personale reflektim të pavarur për çështje gjyqësore, konsiderimi i procedurave alternative, argumentim bindës;
- Orientim në çështje praktike dhe vetëdijesim mbi ndërlidhjen në mes të dimensioneve juridike, sociale dhe ekonomike;
- Kërkesat për finalizim të suksesshëm (vetë-organizimi dhe disiplina, aftësia për t'u përballur me vëllim të lartë pune);

### 5.2 Struktura e PTF

Trajnimi fillestar zgjatë dymbëdhjetë (12) muaj. Përcaktimi kohor me ligj mundëson që trajnimi të jetë intensiv dhe struktura e programit të trajnimit fillestar për vitin 2024/2025 është i ndarë në dy pjesë. Pjesa e parë përfshinë trajnimin teorik i kombinuar me shqyrtime të rasteve nga praktika gjyqësore, simulime etj., ndërsa pjesa e dytë është trajnim praktik i shoqëruar edhe me trajnime në institucione jo gjyqësore që lidhen me punën e gjyqtarit dhe prokurorit.

Për të përcaktuar strukturën e trajnimit fillestar duhet përcaktuar fillimisht se cilat kompetenca duhet të zhvillohen tek gjyqtarët i sapo emëruar, përkatësisht duhet të dimë se cilat janë cilësitë që duhet të t'i ketë një gjyqtarë.

Për zhvillimin e kompetencave tek pjesëmarrësit e trajnimeve AD bazohet në skemën e mëposhtme:

<p><i>Integriteti personal dhe sjellja profesionale</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pavarësia dhe paanshmëria</li> <li>• Vetëbesimi dhe autenticiteti</li> <li>• Angazhim i ndershëm për një gjykim të drejtë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Është i bindur në lidhje me sistemin ligjor dhe cilësinë e tij;</li> <li>- Përfaqëson vendimin e marrë;</li> <li>- Tregon individualitetin dhe qëndrueshmërinë ndaj ndikimit të veprimeve të veta;</li> <li>- Guxon kur është e nevojshme, për të shkuar kundër pikëpamjeve mbizotëruese;</li> <li>- Është i qartë në lidhje me pritjet, vendos kfihtë.</li> </ul>
<p><i>Shkathësitë ligjore dhe gjyqësore</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vendosmëria, marrja e vendimeve gjyqësore</li> <li>• Bindja</li> <li>• Aftësia analitike dhe aftësia për të gjykuar</li> <li>• Përgjegjësia për udhëheqje,</li> <li>• Udhëheqja</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Merr vendime në bazë të të dhënave të disponueshme;</li> <li>- Vepron me vendosmëri edhe kur rritet presioni.</li> <li>- I jep një kuptim të qartë dhe të plotë strukturës së vendimmarrjes dhe procesit të ndjekur në hartimin e vendimeve;</li> <li>- Merr pëlqimin e palëve për vendimin;</li> <li>- I jep kuptim të plotë tekstit të formuluar;</li> <li>- Percepton mundësitë për të sjellë palët së bashku dhe për të ndërmjetësuar në zgjidhjen e kontestit;</li> <li>- Proceson dhe zgjidh një shumëllojshmëri të të dhënave;</li> <li>- Në mënyrë sistematike shqyrton dhe vlerëson;</li> <li>- Bën pyetje në bazë të të kuptuarit;</li> <li>- Diskuton çështje sipas situatave;</li> <li>- Përdor mendime logjike që çojnë në krijimin e deklaratave deri në arsyetim të qartë dhe transparent;</li> <li>- Planifikon dhe organizon punën e vet për rastin;</li> <li>- Përfshinë të tjerët në tema të rëndësishme;</li> <li>- Lejon aty ku është e mundur të tjerët të shtojnë ekspertizën e tyre;</li> <li>- Organizon punën e punonjësve në mënyrë sa më efikase që është e mundur;</li> <li>- Informon të tjerët në lidhje me ecurinë e punës;</li> <li>- Rregullon procedurat (përmbajtja, cilësia dhe përkohshmëria) nëse kërkohet.</li> </ul>
<p><i>Përkushtimi profesional</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Aftësia për menaxhimin e zyrës,</li> <li>• Aftësia për të mësuar dhe vetë-reflektuar</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Zhvillon kapacitetet organizative dhe drejtuese, për të kryesuar seancat e marrjes në pyetje dhe për të udhëhequr takime.</li> <li>- Është i hapur për reagime nga të tjerët dhe i përkushtuar ndaj të mësuarit;</li> </ul>



	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Aftësia për të bashkëpunuar</li> <li>• Fleksibiliteti dhe aftësia për t'u marrë me ngarkesë të punës</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Është kurioz, në mënyrë aktive kërkon risi dhe/apo situata të tjera;</li> <li>- I gatshëm për të marrë pjesë në arsimin profesional dhe i angazhuar në trajnime të rregullta, për të rritur kapacitetet profesionale për legjislacionin vendor dhe ndërkombëtar,</li> <li>- Është i hapur për bashkëpunim me të tjerët;</li> <li>- Merr iniciativë dhe shfrytëzon mundësinë për të ndarë njohuritë, mbështet dhe konsultohet me të tjerët për të përmirësuar cilësinë dhe efikasitetin e drejtësisë;</li> <li>- Shkëmben praktikatat me institucione të lidhura me punën e gjykatave dhe prokurorive;</li> </ul>
<p>Ndërgjegjësimi social</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Dëgjimi dhe komunikimi</li> <li>• Përshtatshmëria</li> <li>• Bindja</li> <li>• Ndërgjegjësimi për mjedisin shoqëror</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Tregon mirëkuptim për situatën e të tjerëve dhe kontakton personalisht dhe ka ndjeshmëri për motivim - të dëgjuarit aktiv - jep ndjesinë për të tjerët që kontributi i tyre është pranuar;</li> <li>- Përshtat qasjen e vet, kur situata ndryshon apo kur ajo dikton, përshtatet në rrethana të veçanta dhe situata të ndryshme;</li> <li>- I jep një kuptim të qartë dhe të plotë strukturës së vendimmarrjes dhe procesit të ndjekur në hartimin e vendimeve;</li> <li>- I jep kuptim të plotë tekstit të formuluar;</li> <li>- Percepton mundësitë për të sjellë palët së bashku dhe për të ndërmjetësuar në zgjidhjen e kontestit.</li> <li>- Ka prirje për zhvillimet sociale dhe formon imazhin e vet në kuadër të ligjit;</li> <li>- Kërkon informacione të vjetra, të reja dhe kontradiktore, perspektiva të ndryshme që mund të ndikojnë në vendim dhe procedurë;</li> <li>- Tregon vetëdije për ndikimin e rrethanave të ndryshme dhe të palëve;</li> <li>- Vlerëson ndikimin e rolit dhe pozitës së tyre në kontekstin social, merr parasysh këtë duke ruajtur distancën;</li> <li>- Ka njohuri në lidhje me kontekstin socio-ekonomik, në të cilën janë praktikuar funksionet;</li> </ul>

PTF është konceptualizuar dhe vënë në kornizë si program kualifikues profesional, i bazuar në kompetenca, i modularizuar dhe i orientuar në vend pune, i cili integron elemente mësimore teorike dhe praktike. Është i disenjuar veçanërisht për zhvillimin profesional fillestar të gjyqtarëve. Është kombinim prej fazave praktike dhe teorike si dhe atyre udhëzuese dhe vetëmësimore, duke përfshirë edhe elemente të e-learning.

## 5.3 Përmbajtja e PTF

Përmbajtja e trajnimit fillestar do të fokusohet në zhvillimin e kompetencave profesionale, vlerat etike dhe ndërdisiplinare të gjyqtarëve të sapoemëruar me theks të veçantë tek:

- Ngritja e kapaciteteve profesionale për legjislacionin vendor dhe ndërkombëtar;
- Hartimi i vendimeve gjyqësore bazuar në analizë të fakteve;
- Aplikimi i rregullave etike;
- Përshtatja me rrethana dhe situata specifike gjatë ushtrimit të funksionit të gjyqtarit/prokurorit;
- Zhvillimi i shkathtësive gjyqësore;
- Zhvillimi i shkathtësive sociale;
- Shkëmbimi i praktikave me institucionet e ndërlidhura me punën e gjykatave dhe prokurorive;
- Zhvillimi i kapaciteteve hulumtuese, organizative dhe menaxhuese;
- Zhvillimi i shkathtësive interdisiplinare.

Këto kompetenca do të zhvillohen përmes moduleve të cilat janë bashkangjitur si aneks i këtij programi, trajnimit praktik, programeve në institucione jo gjyqësore të ndërlidhur me punën e gjykatave dhe prokurorive si dhe punës praktike që i caktohen nga trajnuesit apo mentorët.

### 5.3.1 Pjesa e trajnimit teorik

Në këtë pjesë trajnimi zhvillohet në mënyrë teorike i kombinuar me raste nga praktika gjyqësore, bazuar në module trajnuese ku përfshihen trajnime nga të gjitha degët e së drejtës dhe ligjet pozitive vendore, Acquis Communautaire, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe akte të tjera ndërkombëtare.

Sasia e orëve të punës së programuar për secilin nga modulet të cilët do të realizohen përmes kombinimit me trajnimin praktik, përcaktohet në funksion të:

- Përmbajtjes së modulit trajnues;
- Natyrës dhe vështirësisë së modulit;
- Lloji i modulit dhe rëndësia e tij për praktikën gjyqësore/prokuroriale;

Në përgjithësi programi trajnues i secilit modul përmban të paktën një numër të caktuar të sesioneve trajnuese i realizuar sipas planit të punës.

Në kuadër të programit trajnues përveç moduleve profesionale dhe të karakterit interdisiplinar përfshihen edhe modulet shpesh të cilat do të realizohen nëpërmjet platformës së mësimi në distancë.

### 5.3.2 Pjesa e trajnimit praktik

Pjesa e trajnimit praktik zhvillohet në gjykata. Trajnimi realizohet nën mbikëqyrjen e mentorit (gjyqtarë), i cili është mbikëqyrës për zbatimin e programit trajnues siç është përcaktuar në këtë program dhe doracakun e trajnimit praktik, si dhe për të bërë vlerësimin e performancës së përfituesit gjatë trajnimit. Programi praktik përfshinë çështje nga aspekti profesional, rregullat e komunikimit, menaxhimin e rasteve, etikën dhe çështje tjera të karakterit praktik me interes për përfituesin. Gjatë këtij trajnimi, Gjyqtari i sapoemëruar mund t'i asistoj gjyqtarit

gjatë ushtrimit të funksionit të tij, merr pjesë në aktivitete gjyqësore me rastin e praktikës së tij/saj, por gjithmonë nën udhëheqjen e mentorit.

Programi i trajnimit praktik realizohet mbështetur në “Doracakun për Trajnimin Praktik” i cili përmban programin trajnues që duhet ndjekur gjyqtarët e sapoemëruar dhe specifikon detyrat dhe përgjegjësitë e mentorëve dhe përfituesve gjatë realizimit të trajnimit praktik. Doracaku është pjesë e këtij programi trajnues.

Qëllimi i këtij doracaku është që të përshkruajë rolin dhe përgjegjësitë e mentorëve dhe përfituesve gjatë trajnimit praktik të PTF-së (fazës së mentorimit). Doracaku gjithashtu përshkruan disa nga kompetencat ligjore, etike dhe interdisiplinare që pjesëmarrësit në programin e praktikës duhet t'i përfitojnë gjatë trajnimit praktik.

Mentorëve u janë dhënë edhe ide rreth asaj se si t'i ekspozojnë përfituesit ndaj një game të gjerë të temave që do t'i përgatiste ata të marrin detyrat e tyre zyrtare, pas përfundimit të trajnimit fillestar. Fokusi i doracakut dhe programit të praktikës është që të theksojë rëndësinë e ofrimit të përvojës reale praktike për përfituesit në zhvillimin e aftësive të tyre, duke filluar nga ato profesionale, shkrimi ligjor, të menduarit kritik, etika, rregullat e komunikimit, menaxhimi i rasteve dhe shumë të tjera të karakterit praktik me interes për përfituesit.

Po ashtu, gjatë trajnimit praktik, gjyqtarët e sapoemëruar do të ndjekin një modul të veçantë trajnues i cili realizohet krahas trajnimit praktik. Ky modul ka të bëjë me ngritjen e shkathtësive gjyqësore të përfituesve bazuar në ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale lidhur me marrjen në pyetje dhe udhëheqjen e shqyrtimit gjyqësor. Në mënyrë specifike ngritja e shkathtësive do bëhet për fjalën hyrëse, marrjen e drejtpërdrejtë dhe të tërthorët në pyetje, vënien në dyshim, rehabilitimin dhe fjalën përfundimtare.

Gjatë kësaj pjese të trajnimit pjesëmarrësit mund të ndjekin edhe trajnime në platformën e mësimin në distancë dhe programe të ndryshme praktike në institucionet jo gjyqësore.

Në përfundim të këtij trajnimi, mentorët bëjnë një vlerësim për përfituesit ku përfshihet, performanca e tyre e përgjithshme gjatë trajnimit, aspekti i punës praktike profesionale, respektimi i orarit, etj.

## 5.4 Program trajnimi në institucionet jo gjyqësore

Krahas trajnimit praktik nëpër gjykata, gjyqtarët e sapoemëruar do të ndjekin edhe trajnime në institucione të ndryshme të sistemit të drejtësisë dhe jashtë tyre puna e të cilave është e ndërlidhur me punën e tyre. Kjo do të mundësohet me bashkëpunimin e krijuar në mes të AD-së dhe këtyre institucioneve.

Institucionet në të cilat gjyqtarët e sapoemëruar do të ndjekin trajnime, janë:

- Gjykata Kushtetuese
- Avokati i Popullit
- Policia e Kosovës
- Shërbimi Korrektues
- Shërbimi Sprovues
- Dogana e Kosovës
- Agjencioni për Informim dhe privatësi
- Instituti i Mjekësisë Ligjore

## 5.5 Simulimet e gjykimeve

Përveç metodave të trajnimit tradicional si diskutime interaktive, studimeve të rasteve praktike, përfituesit e trajnimit fillestar gjatë trajnimit do të përfshihen edhe në simulime të gjykimeve.

Simulimi i gjykimeve realizohet përmes përzgjedhjes së rasteve nga praktika gjyqësore nga lëmia penale/civile me përfshirje të elementeve edhe nga fusha tjera të së drejtës.

Qëllimi i simulimit të gjykimit është ngitja e aftësive dhe shkathtësive në të shprehur, rritja e vetëbesimit, zhvillimi i mendimit kritik si dhe aftësia për të punuar në ekip. Gjithashtu përmes simulimit të gjykimit pjesëmarrësit mund të përmirësojnë mënyrën e analizimit dhe arsyetimit të fakteve, zhvillojnë shkathtësinë për të dëgjuar dhe bashkëpunuar, të kuptojnë më mirë sistemin gjyqësor, si dhe të avancojnë njohjen e rregullave të të provuarit para trupit gjykues.

## 5.6 Puna hulumtuese

Në kuadër të kompetencave të trajnimit fillestar përfshihet edhe puna hulumtuese, ku kjo kompetencë realizohet qoftë përmes rasteve praktike gjatë trajnimit si dhe punimeve hulumtuese. Këto punime përmbajnë tema të ndryshme që trajtojnë institute të ndryshme të së drejtës, aspekte të ndryshme nga legjislacioni vendor dhe ndërkombëtar. Qëllimi i këtyre punimeve përveç formimit dhe ngritjes së shkathtësive të përfituesve në sferën e hulumtimit dhe shkrimit ligjor është edhe ofrimi i mbështetjes profesionale për juristët e rinj nëse krijon kushtet për nxjerrjen e revistave të Akademisë. Kjo komponentë vlerësohet ashtu si pjesa praktike dhe teorikë.

## 6. Vlerësimi

Procesi i vlerësimit të përfundimit të suksesshëm të programit trajnues nga gjyqtarët e sapoemëruar përcaktohet me Rregulloren për Programin e Trajnimit Fillestar dhe Rregulloren për Plotësimin dhe Ndryshimi e Rregullores për Programin e Trajnimit Fillestar e miratuar nga Këshilli Drejtues i AD-së. Ky proces realizohet por nuk kufizohet vetëm, përmes raportit për vijueshmërinë në trajnim, raportit të trajnuesve, raportit të mentorëve, dhe vlerësimit për punimet hulumtuese të cilat përmbliken në një raport përfundimtarë të përgatitur nga AD, i cili dërgohet në KGJK-së dhe KPK-së në fund të programit trajnues.

Testimet e pjesëmarrësve mund të bëhen sipas këtij sistemi:

- Testimi përfundimtar për PTF përbëhet nga rezultatet e secilit testim modular;
- Testimet në module mund të zbatohen në forma të ndryshme: teste me shkrim, teste verbale, elaborime me shkrim, prezantime;
- Parakusht për pjesëmarrje në test modular është pjesëmarrja e rregullt në trajnim dhe përmbushja autonome e kërkesave të PTF-së gjatë seancave për trajnim;

Vlerësimi gjatë trajnimit teorik do të bëhet bazuar në skemën e lartshënuar që kanë të bëjnë me zhvillimin e kompetencave tek pjesëmarrësit e trajnimeve bazuar në skemën e mëposhtme, ndërsa i gjithë procesi i vlerësimit të rezultateve të trajnimit do të bazohet në kriteret e përcaktuara me ligj dhe aktet tjera normative për vlerësimin e gjyqtarëve.

## 6.1 Shembull i vlerësimit nga ana e trajnuesit

Formular për vlerësim nga ana e trajnuesit për punën praktike apo rastet praktike të pjesëmarrësve në trajnim, përveç vlerësimeve në provime.

<b>Emri dhe mbiemri i gjyqtarit/prokuratorit të shtetit në PTF:</b>			<b>Moduli Trajnues: I pandehuri në procedurën penale</b>		
<b>Identifikimi i fakteve</b>	<b>Njohja dhe zbatimi i ligjit</b>	<b>Analizimi i fakteve</b>	<b>Konkluzioni dhe arsyetimi</b>	<b>Gjuha e përdorur</b>	<b>Vlerësimi i përgjithshëm</b>
Pamjaftueshëm	Pamjaftueshëm	Pamjaftueshëm	Pamjaftueshëm	Pamjaftueshëm	Pamjaftueshëm
Mjaftueshëm	Mjaftueshëm	Mjaftueshëm	Mjaftueshëm	Mjaftueshëm	Mjaftueshëm
Mirë	Mirë	Mirë	Mirë	Mirë	Mirë
Shumë mirë	Shumë mirë	Shumë mirë	Shumë mirë	Shumë mirë	Shumë mirë
Komenti i trajnuesit dhe rekomandimet ku përfituesi ka nevojë për përmirësim:					

Data: \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_

Emri & Nënshkrimi i Trajnuesit \_\_\_\_\_

## 6.2 Shembull i tabelës së vlerësimit nga ana e Mentorit

	<u>Niveli</u>
Aftësia për t'i identifikuar dhe përdorur rregullat e deontologjisë (Kompetenca “ <b>Integriteti personal dhe sjellja profesionale</b> ”)	E arritur <input type="checkbox"/> Në progres <input type="checkbox"/> E pa arritur <input type="checkbox"/>
Aftësia për të analizuar dhe përshkruar një situatë apo rast (Kompetenca “ <b>Shkathhtësitë ligjore dhe gjyqësore</b> ”)	E arritur <input type="checkbox"/> Në progres <input type="checkbox"/> E pa arritur <input type="checkbox"/>
Aftësia për ti identifikuar, respektuar dhe garantuar rregullat ligjore (Kompetenca “ <b>Shkathhtësitë ligjore dhe gjyqësore</b> ”)	E arritur <input type="checkbox"/> Në progres <input type="checkbox"/> E pa arritur <input type="checkbox"/>
Aftësia për përshtatje dhe adaptim (Kompetenca “ <b>Ndërgjegjësimi social</b> ”)	E arritur <input type="checkbox"/> Në progres <input type="checkbox"/> E pa arritur <input type="checkbox"/>
Aftësia për tu adaptuar dhe për të treguar autoritet në rrethana dhe situata specifike (Kompetenca “ <b>Ndërgjegjësimi social</b> ”)	E arritur <input type="checkbox"/> Në progres <input type="checkbox"/> E pa arritur <input type="checkbox"/>
Aftësia për të pasur marrëdhënie të mirëfillta, dëgjim aktiv dhe shkëmbim informatash (Kompetenca “ <b>Ndërgjegjësimi social</b> ”)	E arritur <input type="checkbox"/> Në progres <input type="checkbox"/> E pa arritur <input type="checkbox"/>
Aftësia për të monitoruar një audiencë në gjykatë, mirëpo me respekt ndaj palës kundërshtare (Kompetenca “ <b>Shkathhtësitë ligjore dhe gjyqësore</b> ”)	E arritur <input type="checkbox"/> Në progres <input type="checkbox"/> E pa arritur <input type="checkbox"/>
Aftësia për të gjetur zgjidhje dhe pajtuar palët (Kompetenca “ <b>Integriteti profesional dhe sjellja profesionale</b> ”)	E arritur <input type="checkbox"/> Në progres <input type="checkbox"/> E pa arritur <input type="checkbox"/>
Aftësia për të marrë vendime të bazuara në drejtësi dhe fakte (Kompetenca “ <b>Shkathhtësitë ligjore dhe gjyqësore</b> ”)	E arritur <input type="checkbox"/> Në progres <input type="checkbox"/> E pa arritur <input type="checkbox"/>
Aftësia për motivim, formalizëm dhe shpjegim të vendimeve (Kompetenca “ <b>Ndërgjegjësimi social</b> ”)	E arritur <input type="checkbox"/> Në progres <input type="checkbox"/> E pa arritur <input type="checkbox"/>
Aftësia për të pasur parasysh rrethanat institucionale kombëtare dhe ndërkombëtare (Kompetenca “ <b>Ndërgjegjësimi social</b> ”)	E arritur <input type="checkbox"/> Në progres <input type="checkbox"/> E pa arritur <input type="checkbox"/>
Aftësia për të punuar në grup (Kompetenca “ <b>Angazhimi profesional</b> ”)	E arritur <input type="checkbox"/> Në progres <input type="checkbox"/> E pa arritur <input type="checkbox"/>
Aftësia për organizimin, menaxhimin dhe marrjen e iniciativave. (Kompetenca “ <b>Angazhimi profesional</b> ”)	E arritur <input type="checkbox"/> Në progres <input type="checkbox"/> E pa arritur <input type="checkbox"/>

## 7. Kalendari dhe orari trajnues

Për realizimin e këtij programi do të hartohet kalendari i aktiviteteve trajnuese. Trajnimi fillestar mbahet 5 ditë në javë. Pjesa e trajnimit teorik mbahet në AD, ndërsa trajnimi praktik në gjykata dhe i shoqëruar me trajnimet në institucionet tjera jo gjyqësore.

Orari i trajnimeve dhe numri i sesioneve trajnuese është përcaktuar në konsultim të ngushtë edhe me të gjithë akterët relevant.

Kushtet e pjesëmarrjes në trajnim dhe mungesave gjatë trajnimit janë të rregulluara me Rregulloren për Trajnimin Fillestar.

## 8. Modulet trajnuese të PTF 2024/2025 për gjyqtarët e sapoemëruar

Modulet e trajnimit fillestar për gjyqtarët e sapoemëruar si dhe sesionet për secilin modul janë si më poshtë:

Modulet Trajnuese				
Nr.	Emërtimi i modulit	Orë trajnimi	Nën moduli / nën pjesa	Nr. i sesioneve
1.	Rendi juridik kombëtarë dhe ndërkombëtarë	57 orë	1.1 Drejtësia kushtetuese në raport me sistemin gjyqësor dhe prokurorial	3
			1.2 Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështje penale dhe civile	4
			1.3 E drejta e BE-së	4
			1.4 Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut	8
2.	Kodi Penal i Republikës së Kosovës	105 orë	2.1 Kodi Penal i Kosovës – pjesa e Përgjithshme	14
			2.2 Kodi Penal i Kosovës – pjesa e veçantë	13
			2.3 Krimi Kibernetikë	2
			2.4 Politika ndëshkimore	4
			2.5 Përgjegjësia e personave juridik	2
3.	Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës	147orë	3.1 Procedura paraprake penale	5
			3.3 Masat e veçanta hetimore	3
			3.4 Parimet, kompetencat dhe përjashtimi i gjyqtarit në procedurën penale	2
			3.5 Masat e sigurisë së të pandehurit në procedurë penale	2
			3.6 Palët në procedurën penale	3

			3.7 Dëshmitarët dhe të dëmtuarit në procedurën penale	3
			3.8 Shqyrtimi fillestar dhe i dytë	3
			3.9 Shqyrtimi gjyqësor	6
			3.10 Shpenzimet e procedurës dhe kërkesat pasurore juridike	1
			3.11 Procedura sipas mjeteve juridike	2
			3.12. Aktgjykimi dhe llojet e tij	3
			3.13 Procedurat penale e kryerësve me çrregullimi mendore	3
			3.14 Procedurat e veçanta sipas KPPK	3
			3.15 Provat në procedurën penale	4
			3.16 Procedurat alternative	6
<b>4.</b>	E drejta civile, administrative dhe ekonomike	255 orë	4.1 E drejta civile	4
			4.2 Procedura Kontestimore-pjesa e parë	12
			4.3 Procedura Kontestimore-pjesa e dytë	12
			4.4 Procedura Jokontestimore	4
			4.5 Procedura Përmbartimore	5
			4.6 E drejta Administrative	5
			4.7 E drejta e Detyrimeve	12
			4.8 E drejta komerciale	9
			4.9 E drejta e Pronësisë dhe të drejtat e tjera sendore	7
			4.10 E drejta e Trashëgimisë	4
			4.11 E drejta e Punës	5
			4.12 E drejta Familjare	5
<b>5.</b>	Shkathësitë personale dhe ndërdisiplinare	63 orë	5.1 Rregullat e komunikimit	2
			5.2 Etikë profesionale dhe përgjegjësia disiplinore	4
			5.3 Menaxhimi i rasteve dhe vlerësimi i performancës	3
			5.4 Arsyetimi i vendimeve gjyqësore	8
			5.5 Ngritja e shkathësive sociale për gjyqtarë dhe menaxhimi i stresit	4
<b>6.</b>	Legjislacioni dhe shkathësitë plotësuese	69 orë	6.1 Kodi i Drejtësisë për të Mitur	6
			6.2 Ndërmjetësimi në çështje civile	1
			6.3 Zhvillimi i shkathësive gjyqësore	8
			6.4 Ligji për kundërvajtje	2
			6.5 Mbrojtja nga diskriminimi	2
			6.6 Dhuna në familje	4



## 9.1 Rendi juridik kombëtarë dhe ndërkombëtarë

### 9.1.1 Drejtësia kushtetuese në raport me sistemin gjyqësor dhe prokurorial

Kushtetuta si akt suprem në hierarkinë e akteve juridike duke të jetë gjithmonë si udhërrëfyes i gjyqtarëve në rastet kur gjyqtarët vendosin për të drejtat dhe liritë e qytetarëve. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese përmes vendimeve të saj ka krijuar precedent të rëndësishëm sa i përket kushtetueshmërisë së ligjeve dhe zbatimit të normave kushtetuese në raport me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive individuale të qytetarëve.

Andaj, në këtë nën - modul do të trajtohet funksioni i Gjykatës Kushtetuese në sistemin ligjor të Kosovës, kompetencat dhe roli i Gjykatës Kushtetuese në sistemin ligjor, duke përfshirë interpretimin e Kushtetutës dhe mbrojtjen e të drejtave themelore në aspektin kushtetues. Gjithashtu do të trajtohet procesi i emërimit dhe përbërja e Gjykatës Kushtetuese duke theksuar pavarësinë dhe profesionalizmin e anëtarëve të saj.

Ky nën - modul po ashtu do të trajtojë efektet e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Në mënyrë të detajuar do të analizohet mënyra se si vendimet e Gjykatës Kushtetuese implementohen në praktikë dhe si ndikojnë në zhvillimin e sistemit juridik e shoqëror në Kosovë. Gjithashtu do të vlerësohet rëndësia e ndikimit të vendimeve në strukturën shtetërore dhe respektimin e ligjit duke marrë parasysh se vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet në Republikën e Kosovës. Tutje, do të analizohet rrethana kur Gjykata Kushtetuese anulon vendimet gjyqësore të gjykatave të rregullta dhe si duhet të veprohet nga këto të fundit për zbatimin e tyre në gjykimin e përsëritshëm të rastit të caktuar.

Po ashtu në këtë nën - modul do të trajtohet edhe kontrolli incidental nga gjykatat e rregullta. Do të analizohen procedurat dhe rrethanat kur një çështje mund të ngritet në Gjykatën Kushtetuese nga gjykatat e rregullta në pajtim me nenin 113.8 të Kushtetutës së Kosovës. Do të shpjegohet roli i gjykatave të rregullta në kontrollin incidental dhe bashkëpunimi i tyre me Gjykatën Kushtetuese për të siguruar zbatimin korrekt të kushtetutës. Po ashtu në këtë pjesë do të analizohet autorizimi i gjykatave të rregullta për zbatimin e normave kushtetuese në pajtim me nenin 102.3 të Kushtetutës së Kosovës.

Adresimi i çështjeve që janë me rëndësi për gjyqtarët e sapo emëruar nga tematika e përmendur do të bëhet përmes shpjegimit të pjesshëm teorik, duke u ndërlidhur me rastet praktike të Gjykatës Kushtetuese. Gjyqtarët do të kenë mundësi të diskutojnë rastet kur plotësohen kushtet për kontroll incidental nga gjykatat e rregullta kur gjyqtarët nuk janë të sigurtë për sigurt për përputhshmërinë e ligjit të kontestuar me Kushtetutën. Gjithashtu përmes diskutimeve interaktive synohet realizimi i një qasje proaktive të pjesëmarrësve.

**Kohëzgjatja: Tri sesione trajnuese (9 orë trajnimi)**

### 9.1.2 Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështje penale dhe civile

Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar paraqitet si mënyrë për të ofruar dhe marrë ndihmë juridike ndërkombëtare ndërmjet gjykatave dhe autoriteteve tjera kompetente vendore dhe të huaja. Kjo paraqitet shpeshherë si sfidë kur gjykata duhet të kërkojë ndihmë juridike ndërkombëtare për të kërkuar informacione apo komunikuar përmes shkresave me personat të cilët jetojnë jashtë vendit e janë të përfshirë në procedura gjyqësore.

Në këtë drejtim, bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet penale paraqitet si nevojë në këto kohë moderne meqë krimi i ka tejkaluar kufijtë e brendshëm dhe ka marrë dimension ndërkombëtar. Në këtë botë gjithnjë e më të ndërvarur, asnjë vend nuk mund të luftoj krimin në mënyrë efektive pa bashkëpunim mes shteteve për të parandaluar dhe për të zbuluar krimin. Kështu që është e një rëndësie të madhe aftësia e shteteve për të ndihmuar njëri-tjetrin shpejt dhe në mënyrë efikase.

Përderisa, kur flitet për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale mendohet në çdo formë të ndihmës së kërkuar apo e ofruar nga një shtet tjetër, organizatë apo institucion, me qëllim të mbështetjes së procedurave penale në çështjet si: (ekstradimi, transferimi i procedurës penale nga shtetet e huaja në Republikën e Kosovës, transferimi i personave të dënuar nga shtetet tjera në Republikën e Kosovës, njohja dhe ekzekutimi i aktgjykimeve të huaja në Republikën e Kosovës, kërkesat vendore për ndihmë juridike të ndërsjellë të drejtuar shtetit tjetër dhe paraqitja e dëshmitarëve, ekspertëve dhe të pandehurve etj).

Ndërsa kur flitet për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në lëminë civile, flitet vetëm për dhënien dhe marrjen e ndihmës juridike ndërkombëtare në çështjet civile dhe komerciale, duke përfshirë çështjet e tatimeve, doganave ose administrative, e as në ato të përgjegjësisë së shtetit për veprimet ose mos veprimet në ushtrimin e autoritetit shtetëror. Ndërsa njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore dhe të arbitrazhit rregullohet me Ligjin për të drejtën ndërkombëtare private dhe nuk hyn në domenin e ligjit për ndihmë juridike ndërkombëtare në çështjet civile.

Kjo tematikë ndër të tjera ngërthen procedurën për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në lëminë civile për kërkesat që burojnë nga Republika e Kosovës, apo nga shtetet e huaja për Kosovën, rolin e gjykatës dhe Departamentit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar (DBNJ) në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë në këtë procedurë, juridiksioni në bazë të Ligjit për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet civile si dhe konventat ndërkombëtare që rregullojnë çështjen e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet civile, siç janë: Konventa e Luganos, Konventa e Hagës, si dhe disa prej konventave më të rëndësishme që rregullojnë çështjen e cekur më lartë.

Në gjykata dhe prokurori çdo ditë e më tepër po paraqiten raste nga më të ndryshme duke filluar nga dhënia e ndihmës minimale juridike - akt lutjet e ndryshme për marrjen e deklaratës së dëshmitarëve apo dorëzimin e dokumenteve/ftesave apo aktvendimeve të ndryshme e deri tek ekstradimi i të kërkuarve sipas akt lutjes së shtetit kërkues.

Pastaj në çështjet civile paraqiten si – kërkesat nga gjykatat e huaja, ose autoritetet e tjera gjyqësore kompetente të huaja, për shërbimin e dokumenteve gjyqësore ose jashtëgjyqësore për të adresuarit në Republikën e Kosovës dhe nga gjykatat e Republikës së Kosovës për shërbimin e dokumenteve gjyqësore ose jashtëgjyqësore të adresuarit në vendet e huaja; kërkesat nga gjykatat e huaja, ose autoritetet e tjera kompetente gjyqësore të huaja, për gjykatat e Republikës së Kosovës për marrjen e dëshmimeve, dhe kërkesat nga gjykatat e Republikës së Kosovës drejtuar autoriteteve tjera kompetente gjyqësore të huaja, për marrjen e dëshmimeve jashtë vendit, dhe kërkesa të tjera nga gjykatat e huaja, ose autoritetet e tjera gjyqësore

kompetente të huaja, lidhur me të drejtën e Kosovës ose format e tjera të mbështetjes procedurale dhe kërkesa ekuivalente nga gjykatat e Republikës së Kosovës për autoritetet tjera kompetente gjyqësore të huaja.

Adresimi i dilemave në praktikë që janë me rëndësi për gjyqtarët e sapo emëruar nga tematika e përmendur do të bëhet përmes shpjegimit të pjesshëm teorik të nocioneve themelore që përmbajnë dispozitat ligjore në fuqi nacionale dhe ato ndërkombëtare dhe aplikimit të tyre përmes trajtimit praktik të komunikimit nga gjykata si marrëse dhe dhënëse e ndihmës juridike ndërkombëtare.

**Kohëzgjatja: Katër sesione trajnuese (12 orë trajnimi)**

### 9.1.4 E Drejta e Bashkimit Evropian

Me këtë nën modul synohet trajtimi i çështjeve dhe ofrimi i njohurive për gjyqtarët e sapo emëruar të Republikës së Kosovës mbi efektin e të drejtës së Bashkimit Evropian. Gjithashtu fokusi do të jetë edhe në analizën e aspekteve të zbatimit të parimeve të së drejtës së BE-së para anëtarësimit në BE me theks pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes për Stabilizim-Asocim. Si do të zërthehet efekti i së drejtës së BE-së pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes për Stabilizim-Asocim.

Republika e Kosovës si vend i rrethit juridik-evropian aktualisht është në fazën e procesit integruar evropian ku pos adoptimit të legjislacionit me standardet e BE-së (aqe komunitare) rëndësi po i kushton reformave në sistemin gjyqësor e veçmas asaj të përgatitjes së gjyqtarëve të sapo emëruar me njohurit e së drejtës evropiane dhe procedurat që zhvillohen në institucionet gjegjëse të Unionit Evropian.

Në këtë modul do të trajtohen proceset integruese (qoftë në aspektin e integriteteve të thelluara gjithashtu edhe atyre të zgjerimit) si dhe në mënyrë më të detajuar origjina e BE-së; familjarizimi me institucionet e Bashkimit Evropian, roli dhe përgjegjësia e tyre, natyra e kompetencave të BE-së; njohja në themel e të drejtës së BE-së (struktura e Traktatit të Bashkimit Evropian, objektivat dhe vlerat e Bashkimit Evropian) njohja me krijimin e së drejtës së BE-së, raporti i kësaj të drejte me atë nacionale dhe ndërkombëtare si dhe procedurat e shqyrtimit gjyqësorë. Gjithashtu do të trajtohen vështirësitë dhe dilemat që lidhen me interpretimin e efektit të së drejtës evropiane në nivel nacional (efekti i drejtpërdrejt dhe i tërthortë) si dhe zbatimi i kësaj të drejte nga ana e gjykatave të Republikës së Kosovës pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes për Stabilizim – Asocimin.

Adresimi i dilemave në praktikë që janë me rëndësi për gjyqtarët e sapo emëruar nga tematika e përmendur do të bëhet përmes shpjegimit të institucioneve të Bashkimit Evropian, rolit dhe përgjegjësisë së tyre, sqarimit të kompetencave të BE-së; njohjes me të drejtën e BE-së, dhe raportin e kësaj të drejte me atë nacionale dhe ndërkombëtare si dhe përmes zërthimit të procedurave të shqyrtimit gjyqësorë veçmas ato që zhvillohen në Gjykatën e Drejtësisë së Bashkimit Evropian (GJDBE). Në zhvillimin e këtij moduli ndër metodat që do të përdoren do të jenë: shpjegime të pjesshme teorike dhe raste nga praktika gjyqësore; diskutime interaktive në grupe të ndara, të cilët do të mbrojnë dhe argumentojnë qëndrime të ndryshme dhe analizë të rasteve gjyqësore. Gjithashtu synohet edhe realizimi i një pjesëmarrjeje aktive të pjesëmarrësve, në mënyrë që edhe ata të kontribuojnë në realizimin e objektivave të modulit. Ky nën modul do të trajtoj: Rolin dhe kompetencat e institucioneve të Bashkimit Evropian, Burimet e së Drejtës së Bashkimit Evropian, Katër Liritë Themelore në Tregun e Brendshëm të Bashkimit Evropian, dhe Shqyrtimi Gjyqësor në Bashkimin Evropian

**Kohëzgjatja: Katër sesione trajnuese (9 orë trajnuese).**

### 9.1.5 Konventa Evropiane për Lirit dhe të Drejtat e Njeriut

Në këtë nën modul do të trajtohet Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) e miratuar nga Këshilli i Evropës, si një ndër instrumentet më të rëndësishme ndërkombëtare në garantimin e të drejtave civile dhe politike të qytetarëve, dhe i cili instrument, paraqet një traktat juridik detyrues për Palët Kontraktuese. Po ashtu, do të shtjellohet roli dhe funksioni i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), e cila ka rol kyç në interpretimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara me këtë Konventë si dhe mbikëqyrjen e zbatimit të Konventës.

Përkundër që Republika e Kosovës ende nuk është palë kontraktuese në këtë Konventë, e njëjta, është bërë pjesë përbërëse e rendit juridik të Kosovës me nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ashtu që të drejtat dhe liritë themelore të përcaktuara në Konventë zbatohen drejtpërsëdrejti në Republikën e Kosovës, ndërsa interpretimi i lirive dhe të drejtave themelore të përcaktuara me Kushtetutë, bëhet në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Andaj, adresimi i dilemave në praktikë që janë me rëndësi për gjyqtarët e sapo emëruar nga tematika e përmendur do të bëhet përmes shtjellimit të nocioneve themelore të të drejtave dhe lirive që burojnë nga kjo Konventë, shpjegimit të efektit juridik të KEDNJ-së në legjislacionin e Kosovës, elaborimin e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të interpretimeve që bënë ajo, me theks të veçantë sa i përket: Të drejtës për liri dhe siguri (neni 5); Të drejtës për një proces të rregullt (neni 6); Të drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare (neni 8); Të drejtës në liritë të shprehjes, përfshirë edhe çështjet që ndërlidhen me mbrojtjen e gazetareve dhe mbrojtjen e sinjalizuesve (neni 10). Gjithashtu, përmes diskutimeve interaktive në grupe të ndara dhe trajtimit të rasteve praktike, pjesëmarrësit do të mbrojnë dhe argumentojnë qëndrimet e tyre si dhe do hartojnë zgjidhje të rasteve praktike duke marrë si referencë standardet e krijuara nga GJEDNJ përmes vendimeve të saj.

**Kohëzgjatja: 8 sesione trajnuese (24 orë trajnimi).**

## 9.2 Kodi Penal i Republikës së Kosovës

### 9.2.1 Kodi Penal – Pjesa e përgjithshme

Pjesa e përgjithshme e Kodit penal është pjesa më e rëndësishme materiale penale. Në këtë pjesë do të trajtohen dhe shtjellohen dispozitat që kanë të bëjnë me parimet bazë të ligjit penal material. Mbi këto premisa synohet që të kuptohen dhe avancohen shkathtësitë e gjyqtarëve të sapo emëruar për zbatimin e ligjit më të favorshëm, kuptimit të veprës penale dhe format e përgjegjësisë penale, shkaqet e përjashtimit të përgjegjësisë penale, format e bashkëpunimit kriminal, llojet e sanksioneve penale që përcakton kodi penal dhe mënyra e aplikimit të tyre në praktikë. Parashkrimi si institut shumë i rëndësishëm, rehabilitim ligjor dhe zbatimi i legjislacionit penal në kuptim të hapësirës së efektit dhe të mbrojtjes së të mirave juridike të vendit. E thënë më thjeshtë kuptimi dhe mundësia e aplikimit të dispozitave të pjesës së përgjithshme në praktikë nga gjyqtarët e riijnë do të lehtësonte jashtëzakonisht shumë zbatimin e pjesës së posaçme të kodit penal si dhe veprat penale të veçanta në sistemin juridik të vendit. Në këtë trajnim do të fokusohet aspekti i interpretimit të këtyre dispozitave duke bërë si fokus primarë aplikimin e dispozitave të tilla në rastet praktike të punës, e duke i analizuar në kontekst me elementet e veprës konkrete penale që do të merrej si rast praktik.

Do të synohet që implementimi i pjesës së përgjithshme të kodit penal të aplikohet mbi bazën e rastit që ngrit dilema që kanë të bëjnë me pjesën e dispozitave të përgjithshme, në mënyrë që gjyqtarët e sapo emëruar të kuptojnë më së miri se si duhet të i qasen aplikimit të kësaj pjese të Kodit penal në punën e tyre.

Rëndësi vendimtare do të jenë trajtimi i dilemave që paraqiten në praktikën e formave të fajësisë që tërheqin edhe përgjegjësinë penale. Pastaj kuptimi i dashjes, pakujdesia, dijenia, dhe qëllimi që janë në vazhdimësi me dilema në praktikën gjyqësore posaçërisht gjyqtarët e rijnë që i hasin. Sanksionet dhe mënyra e implementimit, që shpërfaqin dilema për disa nga sanksionet se a mundet gjyqtari pa propozim të prokurorit të shqiptoj disa nga dënimet plotësuese. Pra do të implementohet kjo pjesë në kontekstin e praktikës dhe problemeve që hasen në praktikë.

Kjo pjesë do të përfshijë dispozitat më të rëndësishme të pjesës së përgjithshme të kodit si në vijim: Bazat dhe kufijtë e sanksioneve, vepra penale dhe përgjegjësia penale, bashkëpunimi ne kryerjen e veprave penale, sanksionet penale – dënimet dhe masat, rehabilitimi dhe parashkrimi, dhe zbatimi i legjislacionit penal.

**Kohëzgjatja: 14 sesione trajnimi ( 42 orë trajnimi)**

### 9.2.2 Kodi Penal –Pjesa e veçantë

Duke pasur parasysh vëllimin e veprave penale që përmban pjesa e veçantë e Kodit Penal të Republikës së Kosovës, gjatë trajnimit do të synohet që pjesëmarrësit të njoftohen, me veprat penale që kanë rëndësinë më të madhe që në momentin e parë kur fillojnë gjyqtarët e sapoemëruar me punën e tyre në gjykatë, pra do të fokusohet në veprat penale që bien në kompetencën e trajtimit të lëndëve nga gjyqtarët fillestar dhe me theks të veçantë ato vepra që janë më të shpeshta në praktikë por duke mos anashkaluar edhe veprat që në praktikë nuk kryhen shpesh. Pjesëmarrësit gjatë trajnimit do të njoftohen me disa vepra penale të disa kapitujve veç e veç, elementet e veprave penale si dhe kush mund të jetë kryerës i veprave penale. Gjithashtu do të njoftohen se cilat vepra penale kryhen me dashje dhe rastet kur kryhen nga pakujdesia. Do të kuptojnë po ashtu elementet dalluese tek vepra penale e formës së kualifikuar në raport me kualifikimin bazë të secilës vepër që do të trajtohet. Do të synohet që ndërtimi i qasjes të bëhet përmes metodave të kombinuara të aspektit interpretues dhe aplikimit në rastet praktike.

Sqarimet më të nevojshme të problemeve praktike që konsistojnë në problemet e përgjithshme në aplikimin e normave, duke filluar me të kuptuarit e elementeve të veçanta se si përmbushen ato në secilin rast me secilën vepër që do të trajtohet, duke ndërtuar rastin në atë mënyrë me shpërfaqjen e dilemave të praktikës në punë për të arritur që të kuptohet se si duhet eliminuar ato dilema në mënyrë që të mos ketë aplikim jo të drejtë të normës konkrete që inkriminon veprën konkrete penale.

Nga pjesa e posaçme do të përfshihen disa vepra penale që janë në kompetencë të gjyqtarëve fillestar dhe po ashtu do të trajtohen me theks të veçantë veprat që më së shumti shpërfaqen në praktike, si në vijim: Veprat penale kundër jetës dhe trupit, veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut, veprat penale kundër të drejtave në marrëdhënien e punës, veprat penale kundër integritetit seksual, veprat penale kundër martesës dhe familjes, veprat penale kundër shëndetit publik, veprat penale kundër narkotikeve, veprat penale kundër ekonomisë, veprat penale kundër pasurisë, veprat penale kundër, mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore, veprat penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë, veprat penale kundër armëve, veprat penale kundër sigurisë së përgjithshme në trafikun publik, veprat penale

kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës, veprat penale kundër rendit publik dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare.

**Kohëzgjatja: 13 sesione përkatësisht 39 orë trajnimi.**

### 9.2.3 Krimi Kibernetik

Me rritjen e krimeve kompjuterike dhe përdorimin e pajisjeve elektronike/digjitale nga kriminelët në vepra penale, gjithnjë e më shumë të dhëna dhe prova gjenden të ruajtura në format elektronik. Për të përballuar këtë mjedis në ndryshim, është e domosdoshme përgatitja e gjyqtarëve në zhvillimin e aftësive për të gjykuar rastet e veprave penale të lidhura me krimin kibernetik.

Përvoja e sugjeron se në shumicën e rasteve, gjyqtarët hasin vështirësi në përballje me realitetet e reja të botës kibernetike. Për këtë arsye, kërkohen përpjekje të posaçme për ngritjen e kapaciteteve të gjyqtarëve që të mund gjykojnë krimin kibernetik dhe të shfrytëzojnë provat elektronike nëpërmjet trajnimit, lidhjes në rrjet dhe specializimit.

Ky nën modul është hartuar për t'i pajisur gjyqtarët me një nivel bazë të njohurive në lidhje me krimin kibernetik dhe provat elektronike. Nën - moduli do të ofrojë informacion praktik po ashtu edhe ligjor në lidhje me temën dhe do të përqendrohet se si këto çështje ndikojnë në punën e përditshme të gjyqtarëve.

Gjyqtarët luajnë një rol të rëndësishëm në gjykimin e individëve ose grupeve që kryejnë krime. Me rritjen e numrit të krimeve që kanë brenda tyre elemente të krimit kibernetik ose të provave elektronike, rritet nevoja që gjyqtarët të jenë të trajnuar siç duhet dhe të kuptojnë natyrën e këtyre krimeve dhe gjithashtu të jenë të përditësuar me legjislacionin dhe instrumentet e bashkëpunimit ndërkombëtar të disponueshme për trajtimin e këtyre çështjeve.

Ky nën modul do të përmbajë udhëzime dhe instrumente të bashkëpunimit ndërkombëtar, të cilat mund të përdoren gjatë hetimit të çështjeve të krimit kibernetik, duke përfshirë përdorimin 24/7 të pikave të kontaktit, MLA, Aktivitetin e Bashkëpunimit Gjyqësor, Platformat e Bashkëpunimit Gjyqësor, etj.

Në këtë nën modul do të trajtohen provat elektronike, sigurimi dhe marrja e tyre në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit Kibernetik si dhe dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës. Do të trajtohen po ashtu burimet e provave elektronike në internet, sfidat e marrjes së provave nga një juridiksion tjetër si dhe çështjet e pranueshmërisë së provave elektronike në procedimet gjyqësore, përsa i takon vërtetësisë, saktësisë, dhe plotësisë së tyre.

**Kohëzgjatja: 2 sesione trajnuese apo (6 orë trajnimi).**

### 9.2.4 Politika ndëshkimore

Udhëzuesi për politiken ndëshkimore ka për qëllim që të mundësoj aplikimin e metodologjisë që Gjykata Supreme e Kosovës ka përcaktuar për të arritur një qëllim të drejtë vendimi gjyqësor kur bëhet fjalë për matjen e dënimit ndaj të akuzuarit i cili gjendet fajtor për veprën penale që akuzohet. Përmes këtij udhëzuesi gjyqtarët do të jenë në gjendje që duke aplikuar dhe peshuar rrethanat për matjen e dënimit të arrijnë dy parime kryesore të të drejtës penale që gjithashtu mishërohen në kuadër të dispozitave kushtetuese si të drejta dhe liri themelore të njeriut. Parimi i parë që do të implementimet është parimi i ligjshmërisë, pasi që duke aplikuar me një metodologji standarde rrethanat rënduese dhe lehtësues çdo qytetarë do të jetë i barabartë para ligjit duke mos pasur impakt standardi për aplikim të një rrethane tek një i

akuzuar ndryshe e tek një tjetër ndryshe. Parimi i dytë që do të arrihet do të jetë proporcionaliteti i dënimit në të drejtën penale që iu shqiptohet të akuzuarve kur ata gjinden fajtores për veprat penale që akuzohen, andaj duke pasur një metodologji standarde të aplikimit të rrethanave për matjen e dënimit, e cila metodologji është inkorporuar në udhëzues do të implementohet edhe parimi i proporcionalitetit të dënimit në të drejtën penale që njëherë është edhe e drejtë themelore e njeriut e inkorporuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Përmes këtij nën moduli do të synohet që aplikimi i rrethanave të matjes së dënimit të sqarohet duke marrë për bazë rastet praktike specifike, të ashtuquajtur, “Raste pozitive dhe raste negative”, e mbi të cilat do të inkorporohet sqarimi specifik sipas rastit se cilat janë rrethanat që argumentojnë dënimin e tillë, si të arsyetohen ato për të qenë një vendim gjyqësor i kënaqshëm për palët por edhe për publikun e gjerë duke e bindur çdo palë që gjykata maksimalisht ishte e vëmendshme për rrethanat që ndikuan në një dënim të tillë.

Dilemat që në vazhdimësi kanë përcjellë punën e gjyqtareve të rijnë por jo vetëm ka qenë se a duhet të ketë një pikë fillestare ku pastaj mbi peshohen rrethanat lehtësuese dhe rënduese, andaj do të synohet edhe sqarimi i aplikimit të pikës fillestare të matjes së dënimit. Do të adresohen edhe aplikimi i rrethanave rënduese dhe mos dyfishimi i vlerësimit të rrethanave rënduese apo lehtësuese, kjo do të mundësonte gjyqtarëve të rijnë që të eliminojnë mëdyshjet mbi argumentin e qëndrueshëm se dënimin e tillë është proporcional me veprën penale por edhe do të mundësonte aplikimin e drejt të parimit të ligjshmërisë, mbi të gjitha këto do të adresohen problemet dhe dilemat praktike që dominojnë sistemin gjyqësor aktualisht në implementimin e udhëzuesit për politikën ndëshkimore, gjithnjë në përputhshmërinë me parimet e qëllimit të dënimeve sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Ky nën modul do të trajtoj: Kuptimin e implementimit të udhëzuesit, rrethanat rënduese të matjes së dënimit, rrethanat lehtësuese të matjes së dënimit, pika fillestare e matjes së dënimit, mundësia e aplikimit të dënimit me e butë sipas rrethanave dhe rastit konkret, mos dyfishimi i vlerësimit të rrethanave rënduese dhe lehtësuese.

**Kohëzgjatja: 4 sesione trajnuese (12 orë trajnimi).**

### 9.2.5 Përgjegjësia e personave juridik

Duke qenë se zhvillimin i përgjithshëm shoqëror ka avancuar në Kosovë e meqë sistemi juridik i vendit ka përcaktuar mbrojtjen gjyqësore edhe kur të mirat e mbrojtura nga veprimet inkriminuese cenohen nga personat juridik, ku mbrojtja e të mirave është inkorporuar edhe me ligjin e veçantë që është Ligji për përgjegjësin e personave juridik për veprat penale, konsiderohet e nevojshme dhe e domosdoshme që gjyqtarët e sapo emëruar të kenë njohurit mbi aspektet e rregullimit juridik të përgjegjësisë penale të personave juridik për veprat penale, që është një mënyrë tjetër e rregullimit nga ajo e personave fizik. Prandaj ky nën modul synon që të trajtoj mënyrën e përgjegjësisë penale të personave juridik duke qenë se sanksionet e tilla kanë dallim diametralisht të madhe me sanksionet që parasheh Kodi Penal për personat fizik, mirëpo në anën tjetër po pikërisht për përgjegjësin penale të personave juridik aplikohen dispozitat dhe nocionet e kodit penale, siç janë, vepra penale, mbrojtja e nevojshme, nevoja ekstreme etj, edhe tek personat juridik kur ndaj tyre zhvillohet procedurë penale.

Kosova në të kaluarën pjesë të sistemit juridik e ka pasur një rregullat të që janë përcaktuar si delikte ekonomike, tani meqenëse personat juridik mundë të shfrytëzohen si mbulim në aktivitetet e ndryshme kriminale të personave përgjegjës, është miratuar ligji për përgjegjësin e personave juridik për veprat penale, gjithnjë me qëllim që të mbrohen të mirat që ka si synim e drejta penale. Madje personat juridike nga praktika me së shpeshti vijnë në shprehje kur inkriminohen në disa kapituj të veprave penale, siç janë, veprat penale kundër ekonomisë, veprat penale kundër administrimit të drejtësisë, veprat penale kundër detyrës zyrtare, veprat penale nga marrëdhënia e punës, veprat penale kundër ambientit, etj, por duke mos përjashtuar

veprime inkriminuese edhe tek veprat e tjera penale andaj edhe qasja do të jete kombinimi i konstatimeve të përgjegjësive se personit përgjegjës dhe si supozohet përgjegjësia e personit juridik karshi veprimeve të personit përgjegjës.

Si dilema në praktike që do të synohet të trajtohen do të jetë, përgjegjësia e supozuar e personit përgjegjës, duke qenë se ligji mbi shoqëritë tregtare por edhe ligjet tjera që lejojnë organizimin dhe themelimin e personave juridik kanë një mori të mënyrës së funksionimit po ashtu do të synohet që të bëhet ndarja e personave përgjegjës në kuadër të vet personave juridik që themelohen dhe regjistrohen në Kosovë. Cilat janë llojet e sanksioneve që mund t'iu shqiptohen personave juridik, çfarë mënyre e zhvillimit të procedurës duhet të bëhet a është e mundur zhvillimin paralel i procedurës penale dhe si bëhet ajo kur ka arsyeshmëri të ndarjes së procedurave të personit përgjegjës dhe personit juridik, si aplikohen dispozitat e përgjithshme të Kodit Penal. A lejon Kushtetuta e vendit gjykim dhe shqiptim të sanksionit penal mbi bazën e përgjegjësive së supozuar dhe perse ekziston një zgjidhje e tillë, aplikim të rasteve studimore nga praktika.

Ky nën modul do të trajtoj kuptimi i personit përgjegjës varësisht nga organizimi i personit juridik, përgjegjësia e supozuar e personit juridik mbi përgjegjësin e personit përgjegjës të vërtetuar, llojet e sanksioneve dhe masat e sigurisë që mund të shqiptohen personave juridik, parashkrimi i ndjekjes dhe masave dhe procedura penale unike.

**Kohëzgjatja: 2 sesione gjegjësisht (6 orë trajnimi)**

## 9.3 Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës

### 9.3.1 Procedura paraprake penale

Gjatë zhvillimit të procedurës penale shpesh herë zhvillohen disa veprime parapenale të organeve që procedojnë gjatë veprimtarisë së tyre dhe të cilat veprime do të duhej që të kenë bazën ligjore në dispozitat e KPP-së. Me qëllim që këto veprime parapenale të jenë të ligjshme nevojitet që të ketë njohuri nga ana e gjyqtarit të procedurës paraprake, dhe për më tepër, disa veprime janë të ndërlidhura me dhënien e lejes paraprake nga ana e gjyqtarit të procedurës paraprake.

Sipas Kodit të Procedurës Penale [KPP], gjyqtari i procedurës paraprake ka një rol të rëndësishëm në procedurën penale paraprake. Ky gjyqtar në çdo rast shërben nga fillimi i procedurës penale e deri në fazën e ngritjen se aktakuzës. E rëndësishme në këtë stad të procedurës penale është fakti se gjyqtari ka për qëllim garantimin e zhvillimit të një procesi të rregullt gjyqësor i cili mund të jetë për faktin se mund të kemi privim nga liria të personave që ende nuk ka filluar procedura penale që mund të jetë në fazën e ndalimit përkatësisht arrestimit të tij. Po ashtu roli i gjyqtarit të procedurës paraprake ndërlidhet edhe me të drejtat e të dëmtuarit në procedurës dhe aspekte tjera që janë të rëndësishme për etapat e ardhshme të procedurës penale.

Gjyqtari i procedurës paraprake, gjatë fazës së hetimeve është kompetent për të vendosur për masat për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurën penale, për të urdhëruar kontrollimin e personit, sendit dhe objekteve, për të urdhëruar masat e fshehta të hetimit, për të zhvilluar mundësinë e jashtëzakonshme të hetimit, për të urdhëruar sekuestrimin, ngrirjen dhe masat e përkohshme mbi pasurinë si dhe për të urdhëruar ekspertizat të cilat janë në kompetencë ekskluzive të gjykatës.



Andaj, trajtimi i kësaj teme është i rëndësie të veçantë kjo edhe duke marrë parasysh se në këtë stad të procedurës penale mund të vije deri të gabimet e organeve që merren me trajtimin e tyre, ashtu që gjyqtari ka një rol të garantuesit dhe kontrolluesit se procedura është duke u zhvilluar në harmoni me dispozitat e KPP-së.

Në këtë modul do të trajtohet: Procedura paraprake dhe roli i gjyqtarit të procedurës paraprake në këtë fazë të procedurës penale, roli i gjyqtarit në caktimin dhe vazhdimin e masave për sigurimin e prezencës së të pandehurve në procedurë penale, kontrolli i personit, sendit dhe i objekteve, sekuestrimi i përkohshëm dhe konfiskimi sipas kompetencave të zgjeruara dhe roli i gjyqtarit të procedurës paraprake në ndërmarrjen e këtyre veprimeve.

**Kohëzgjatja: 5 sesione trajnuese (15 orë trajnimi).**

### 9.3.3 Masat e veçanta hetimore

Kodi i Procedurës Penale të Kosovës (KPP) me qëllim krijimit të një bazë të mirë të hetimit të kryerësve të veprave penale, ka paraparë një varg mjetesh për sigurimin e provave, mes tjerash, duke përfshirë edhe masat e veçanta hetimore. Këto masa të veçanta hetimore që parashihen në KPP si të tilla janë me qëllim të kundërvënies ndaj kryerësve të veprave të rënda penale e posaçërisht kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, paraqesin kufizim të përkohshëm të drejtave të garantuara me Kushtetutën e Republikës të Kosovës si dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Megjithatë, këto masa paraqesin një mundësi jashtëzakonisht të rëndësishme dhe efektive për sigurimin e provave në procedurë penale. Në Kodin e Procedurës Penale janë përcaktuar llojet e masave të veçanta hetimore dhe organi kompetent për lëshimin apo urdhërimin e tyre. Gjithashtu janë të përcaktuara edhe kushtet në bazë të cilave jepet urdhri për këto masa, organi kompetent që duhet të paraqes kërkesën për këto masa, përmbajtjen e kërkesës, përmbajtjen e urdhëresës për masat e veçanta hetimore, periudhën brenda së cilës cilën duhet të zbatohet ajo urdhëresë, mjete juridik (ankesa) ndaj masës së padrejtë si dhe organi i cili duhet të shqyrtoj këtë ankesë.

Me dispozitat e KPP, janë përcaktuar edhe standardet për pranimin e materialit të mbledhur me masa të veçanta hetimore. Gjithashtu është garantuar e drejta në kundërshtimin e ligjshmërisë së urdhrave gjyqësor dhe zbatimit të tyre, si dhe drejta në kundërshtimi i provave të siguruara me masa të veçanta hetimore. Përveç kësaj, është rregulluar dhe e drejta në kompensimin e dëmit në rastet kur një person i është nënshtruar një mase të veçantë hetimore, kur rezulton se urdhri dhe zbatimi i tij kanë qenë të kundërligjshëm.

Andaj, në fokus të këtij trajnimit do të jenë llojet e masave të veçanta hetimore, kushtet dhe kriteret ligjore për aplikimin e tyre, procedurat për lëshimin e tyre si dhe pranueshmëria e provave të siguruar përmes masave të veçanta hetimore. Gjatë trajtimit të modulit do të prezantohen rastet praktike që janë trajtuar dhe kanë marrë formën e prerë, kombinimi i rasteve praktike me dispozitat ligjore, qasja praktike e interpretimit të ligjit dhe dispozitave ligjore.

Në përmbajtje ky nën modul do të përfshijë: Parimet bazë për të urdhëruar masat e veçanta hetimore, kuptimi, lloji dhe kriteret apo kushtet ligjore për lëshimin e këtyre masave, urdhrat gjyqësor dhe përmbajtja e tyre dhe pranueshmëria e materialeve të siguruara përmes masave të veçanta hetimore.

**Kohëzgjatja: 3 sesione trajnues apo 9 orë trajnimi.**

### 9.3.4 Parimet, Kompetenca dhe Përfashtimi i gjyqtarit në procedurën penale

Ky nën modul do të trajtoj aspekte të dispozitave që gjejnë zbatim gjatë gjithë fazës së procedurës penale, mbi këtë standard do të synohet që të trajtohen këto dispozita si të tilla përgjithshme në kontekst me raste praktike që do të merren për tu elaboruan.

**Parimet e Procedurës** – do të interpretohen në kuptimin e rolit dhe rëndësisë së tyre në procedurën penale se si ato krijojnë një standardë formal procedural për të ndihmuar edhe vet gjykatën për të ardhur deri te e vërteta dhe për të ruajtur vet kredibilitetin e një sistemi gjyqësor, si ato ruajnë dhe mbrojnë te drejtat dhe liritë e njeriut ne procedurën penale.

**Kompetencat e gjykatës** – do te interpretohen ne kuptimin e ndërlidhshmërisë së efikasitetit të procedurës dhe legjitimitetit e ligjshmërisë së gjykatës që merr vendimin, pra për te rezultuar një vendim i ligjshëm dhe legjitim nga gjykata.

**Përfashtimi i gjyqtarit dhe prokurorit** – do ti jap kandidatit mundësi që të kuptojë me saktësi përfashtimin obligator dhe fakultativ nga një çështje gjyqësore ne proces, po ashtu do te kuptojnë rrethanat e shkaqeve te përfashtimit, procedura e përfashtimit, mbrojtja e integritetit te procesit me rastin e përfashtimit, implikimi i etikes dhe integritetit te gjyqtarit me rastin e përfashtimit.

Qasja do të jetë e ndërtuar tërësisht interaktive me qëllimin e vetëm që të kuptohen sa më mirë dispozitat ligjore dhe kur kemi të bëjmë me rastin praktik si ato duhet te implementohen në çfarë mase dhe për cilat shkaqe.

Do të bëhet interpretimi sa më konciz sa më i drejt se kur mundë të kemi një shmangie nga parimet e procedurës nën çfarë rrethanash dhe për cilat arsye, cilat janë fazat e kontrollit dhe mënyrës së kontrollit të kompetencës dhe si duhet vepruar. Cilat rrethana shkaktojnë përfashtimin dhe si duhet të shpërfaqen ato rrethana për të ruajtur integritetin e procesit gjyqësor para publikut por edhe për të shmangur ndonjë papërshtatshmëri të gjyqtarit, me theks të veçantë do të trajtohen në kuptim të dilemave rrethanat fakultative që shkaktojnë përfashtimin dhe si duhet të veprohet.

Ky nën modul do të trajtoj: Parimet e Procedurës, dhe kompetencat e gjykatës dhe përfashtimi i gjyqtarit dhe prokurorit.

**Kohëzgjatja: 2 sesione apo 6 orë trajnimi.**

### 9.3.4 Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurën penale

Masat për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurën penale, me të cilat bëhet kufizimi i lirisë së lëvizjes, me qëllim të zhvillimit me sukses të procedurës penale, kodi i procedurës penale përcakton kushtet që duhet të përmbushen me rastin e caktimit të tyre duke marrë për bazë kushtin thelbësore pra dyshimin e bazuar për vepër penale të caktuar.

Kodi i Procedurës Penale përcakton një gamë masash për të siguruar prezencën e të pandehurit në procedurë penale, nga masat më të lehta deri tek masat të cilat kufizojnë lirinë e lëvizjes së të pandehurit. Është e domosdoshme që të kuptohet nga gjyqtarët e sapoemëruar mënyra e vlerësimit të kushteve për caktimin e këtyre masave dhe rrethanat që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të tyre.

Ky modul do te trajtoj të gjitha masat për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurë penale, gjegjësisht Thirrjen, Urdhër-arrestit; Premtimi i të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin, ndalimi për tu afruar vendit ose personit të caktuar, paraqitja në stacionin policor, dorëzania, arresti shtëpiak dhe paraburgimi.

Posaçërisht, kujdes do t'i kushtohet trajtimit të masës së arrestit shtëpiak dhe paraburgimit, si masa më të rënda. Sipas instrumenteve ndërkombëtare por edhe sipas legjislacionit tonë kërkohet që paraburgimi të aplikohet vetëm kur me masat tjera alternative nuk mund të arrihet të sigurohet prezenca e të pandehurit në procedurë penale. Këto masa në procedurë shpeshherë nuk janë zbatuar sipas mënyrës dhe kushteve të parapara sipas kodit të procedurës penale, andaj në praktikën tonë ende ka vështirësi në analizimin dhe vlerësimin e rrethanave lidhur me vendosjen për këto masa. Po ashtu në praktikë, për këto masa e veçanërisht për paraburgim, ka vështirësi në arsyetimin e bazave për caktimin e këtyre masave sepse dispozitat ligjore kërkojnë që për secilën bazë ligjore të këtë arsyetim konkret e jo abstrakt.

Për të adresuar këto dilemat në praktikë, gjyqtarët e sapo emëruar, përveç prezantimit të materialeve, bashkëbisedimit, prezantimit të rasteve nga praktika gjyqësore po ashtu do të ndahen në grupe për të diskutuar për rastet hipotetike duke shprehur mendimet për zgjidhjen e tyre në praktikë.

**Kohëzgjatja: Dy (2) sesione trajnuese (6 orë trajnim)**

### 9.3.5 Palët në procedurë

Maxima juridike “nemo iudex sine actore” përcakton qartë se nuk ka gjykim pa subjekte procedurale. Prandaj, në këtë nën modul do të trajtohet roli i tyre në procedure penale. Se cili është roli dhe obligimet e Prokurorit të shtetit në një procedure penale, kush mund të jetë mbrojtësit në një procedure penale dhe cilat janë të drejtat dhe obligimet e tyre, a respektohet pozita procedural e të dëmtuarit në një rast të caktuar penal në praktikën tonë gjyqësore, a njoftohet gjatë të gjitha fazave të procedurës penale, dhe në çfarë pozite procedural gjendet i pandehuri që nga fillimi e deri në përfundim të në procedure penale.

Për të gjitha këto pyetjet dhe dilemat tjera që shfaqen në praktikën tonë gjyqësore në këtë nën modul do të adresohen me qëllim të zbatimit të drejtë dhe të plotë të dispozitave të procedurës penale lidhur me rolin dhe pozita e palëve në procedurë penale.

Ky nën modul do të trajtoj: Kompetencat dhe struktura e prokurorit të shtetit, pavarësia e prokurorit të shtetit, detyrimi i prokurorit të shtetit ndaj të pandehurit, detyrat dhe kompetencat e prokurorit të shtetit, kompetenca territoriale e prokurorëve të shtetit, kompetenca e prokurorëve të shtetit në çështjet urgjente, tërheqja nga ndjekja penale, e drejta e të pandehurit për të pasur mbrojtës, kualifikimet e mbrojtësit, kufizimet në përfaqësim nga mbrojtësi, përjashtimi i mbrojtësit, mbrojtësi në rastet e mbrojtjes së detyruar, të drejtat e të dëmtuarit, përfaqësuesi i të dëmtuarit, i pandehuri si subjekt i procedurës penale, deklarimi i të pandehurit si provë, të drejtat dhe detyrimet e tij gjatë procedurës penale dhe pozita procedurale e të pandehurit që nga ngritja e aktakuzës e deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësorë gjegjësisht përfundimit të procedurës penale me vendim të formës së prerë ndaj tij.

**Kohëzgjatja: Tri sesione trajnuese ( 9 orë trajnimi).**

### 9.3.6 Dëshmitarët dhe të dëmtuarit në procedurën penale

Një ndër provat e rëndësishme që shërben për të vërtetuar një gjendje faktike në mënyrë të plotë dhe e drejtë në një çështje penale është edhe dëshmia e dëshmitarit dhe të dëmtuarit në cilësinë e dëshmitarit. Gjithashtu një çështje mjaft më rëndësi në procedurën penale është edhe trajtimi i dëshmitarëve dhe të dëmtuarve që kanë nevojë për mbrojtje për shkak të kanosjes së rrezikut serioz për atë dëshmitar apo familjen e tij dhe në këto raste paraqitet nevoja e

ndërmarrjes së veprimeve nga të gjitha institucionet e implikuar në procedurën penale siç janë: policia, prokuroria dhe gjykata.

Përmes këtij moduli synohet që pjesëmarrësit të mësojnë për llojet e dëshmitarëve, dallimin në mes tyre, mbrojtjen dhe mënyrat e intervistimit të dëshmitarëve, përpilimin e procesverbaleve për intervistimin e dëshmitarëve si dhe rastet kur dëshmia e dëshmitarit konsiderohet si provë e papranueshme në procedurën penale.

Rëndësi të posaçme do t'i kushtohet dëshmitarëve të liruar nga dëshmimi si dhe dëshmitarëve të privilegjuar. Veç e veç do të trajtohen dëshmitarët e liruar nga detyrimi për të dëshmuar si dhe rastet kur si dëshmitar nuk mund të merret në pyetje për shkak të trajtimit si dëshmitar i privilegjuar. Gjithashtu do të trajtohet dëshmitari bashkëpunues, statusi i tij si dëshmitar bashkëpunues, marrëveshja me dëshmitarin bashkëpunues dhe përmbajtja e saj si dhe masat për mbrojtje të posaçme për dëshmitarin bashkëpunues dhe familjen e tij.

Gjithashtu një pjesë e këtij moduli do t'i kushtohet edhe të dëmtuarit i cili mund të jetë jo vetëm palë në procedurë por edhe dëshmitar.

**Kohëzgjatja: Tri sesione trajnuese (9 orë trajnimi).**

### 9.3.7 Shqyrtimi fillestar dhe i dytë

Pas ngritjes së aktakuzës, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues duhet që ta caktojë shqyrtimin fillestar, me ç'rast pas leximit të aktakuzës, të pandehurit i ipet mundësia që ta pranojë fajësinë ose të deklarohej i pafajshëm. Nëse i pandehuri e pranon fajësinë, atëherë, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues ka tri mundësi: të vazhdon me shqiptimin e dënimit ndaj të pandehurit; të caktojë seancë për vërtetimin e ndonjë fakti relevant për dënimin ose të pezullon dënimin deri në përfundimin e bashkëpunimit të të pandehurit me prokurorin e shtetit. Nëse i pandehuri nuk e pranon fajësinë apo nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues me aktvendim e refuzon pranimin e fajësisë, atëherë gjatë shqyrtimit fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues ka këto dy mundësi: që të caktojë shqyrtimin e dytë jo më herët se tridhjetë ditë pas shqyrtimit fillestar dhe jo më vonë se dyzet ditë pas shqyrtimit fillestar ose të kërkojë vetëm paraqitjen e kundërshtimeve (kërkesave) deri në datën e caktuar e cila nuk mund të jetë më vonë se tridhjetë ditë nga shqyrtimi fillestar. Këto dhe shumë çështje tjera që kanë të bëjnë me shqyrtimin fillestar dhe shqyrtimin e dytë, si dhe me kundërshtimin e provat dhe kërkesën për hedhjen e aktakuzës, do të jenë objekt i trajtimit gjatë këtij nën moduli. Gjithashtu, gjatë trajtimit të këtyre temave, gjyqtarët e sapoemëruar do të kemi mundësi që t'i analizojmë shumë situata të cilat mund të vijnë në shprehja gjatë punës së tyre e që ndërlihdhen me kontrollimin paraprak të aktakuzës, se si duhet që të veprojnë gjyqtari në rastet kur aktakuza përmban mangësi të theksuara, se si duhet që të veprojnë në rastet kur vendoset përkitazi me pranimin ose jo të fajësisë dhe çështjet tjera që ndërlihdhen me shqyrtimin e dytë, duke përfshirë këtu edhe vendosjen përkitazi me kundërshtimin e provave dhe kërkesën për hedhjen e aktakuzës. Ky modul do të shqyrtojë këto tema: Kontrollimi paraprak i aktakuzës, shqyrtimi fillestar, aktgjykimi në bazë të pranimit të fajësisë në shqyrtim fillestar, kundërshtimi i provave dhe kërkesa për hedhjen e aktakuzës, shqyrtimi i dytë dhe aktvendimi i gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues në lidhje me kundërshtimin e provave dhe kërkesën për hedhjen e aktakuzës.

**Kohëzgjatja: 3 sesione trajnuese ( 9 orë trajnimi).**

### 9.3.8 Shqyrtimi gjyqësor

Shqyrtimi gjyqësor konsiderohet faza më e rëndësishme e procedurës penale, ku e gjithë veprimtaria e shqyrtimit gjyqësor përmbledhet në: fillimin e shqyrtimit gjyqësor dhe deklarimin e të akuzuarit, prezantimin (paraqitja) e provave dhe fjalën përfundimtare të palëve. Mirëpo, duhet theksuar se nëse i akuzuari e pranon fajësinë, atëherë pas fillimit të shqyrtimit gjyqësor dhe deklarimit të të akuzuarit, kalohet menjëherë në fjalën përfundimtare të palëve. Me qëllim që shqyrtimi gjyqësor të zhvillohet me sukses dhe pa pengesa, atëherë nevojitet që gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues më parë të bëjë përgatitje të caktuara. Këto përgatitje kanë të bëjnë si me caktimin e shqyrtimit gjyqësor, ashtu edhe me çështje tjera përgatitore. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e drejtojnë shqyrtimin gjyqësor, kujdesën për shqyrtimin e gjithanshëm dhe të drejtë të çështjes në pajtim me administrimin e provave, siç parashihet me KPP, si dhe vendosin për propozimet e palëve. Këto dhe shumë çështje tjera që kanë të bëjnë me shqyrtimin gjyqësor do të jenë objekt i trajtimit gjatë këtij nën moduli. Në veçanti, gjyqtarët e sapoemëruar do të kenë mundësi që t'i adresojnë të gjitha çështjet që mund të përballen gjatë praktikës së tyre gjyqësore e që kanë të bëjnë përgatitjen e shqyrtimit gjyqësor, publicitetin e shqyrtimit gjyqësor, zbatimin e shqyrtimit gjyqësor, parakushtet për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, shtyrjen, ndërprerjen dhe afatet e përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor, rrjedhën e shqyrtimit gjyqësor, etj. Ky modul do të trajtojë: Përgatitjet e shqyrtimit gjyqësor, publiciteti i shqyrtimit gjyqësor, zbatimi i shqyrtimit gjyqësor, leximi i aktakuzës dhe deklarimi i të akuzuarit, rrjedha e shqyrtimit gjyqësor, si dhe procesverbali i shqyrtimit gjyqësor dhe seanca për këshillim dhe votim.

**Kohëzgjatja: 6 (gjashtë) sesione trajnuese apo 18 orë trajnimi.**

### 9.3.9 Shpenzimet e procedurës dhe kërkesat pasurore juridike

Në çdo procedurë penale të filluar dhe të përfunduar ndaj të pandehurit, pa marrë parasysh se në çfarë formë do të përfundoj, me të njëjtin vendim do të duhet të vendoset edhe për shpenzimet e procedurës penale dhe lidhur me kërkesën pasurore juridike. Mirëpo, në praktikën gjyqësore jo rrallë herë paraqitet situata kur lidhur me shpenzimet e procedurës penale të mos mund të vendoset me aktgjykimin përkatës por kjo lihet që të vendoset me vendim të veçantë posa të sigurohen të dhënat e nevojshme për përllogaritjen e shpenzimeve të procedurës penale. Edhe sa i përket kërkesave pasurore juridike në procedurën penale jo rrallë herë mund të përcaktohet saktë vlera dhe lartësia e tyre andaj për këtë pala e dëmtuar udhëzohet që këtë kërkesë të realizoj në procedurë civile. Sidomos sfidues mbetet edhe vendimi dhe arsyetimet përkatës lidhur anulimin e veprimeve të caktuara juridike. Andaj, të gjitha pyetjet dhe dilemat tjera që shfaqen në praktikën tonë gjyqësore në këtë nën modul do të adresohen me qëllim të zbatimit të drejtë dhe të plotë të dispozitave të procedurës penale lidhur me shpenzimet e procedurës penale dhe kërkesave pasurore-juridike. Për t'ju qasur dhe adresuar këto dilema në praktikë, gjyqtarëve të sapo emëruar, përveç prezantimit të materialit trajnues, të njëjti do të mund të shprehin edhe përvojat gjatë praktikës së tyre dhe mënyrën e zgjidhjes së këtyre dilemave. Po ashtu dhe nëpërmjet rasteve hipotetike do t'ju ipet mundësia që të njëjti të zgjerojnë njohurit e tyre në atë mënyrë që do të shprehin mendimet e tyre se si kishin me ju qasë adresimit në praktikë. Ky nën modul do të trajtojë: Llojin e shpenzimeve të procedurës penale, aktvendimi për shpenzimet e procedurës penale, pagimi i shpenzimeve sipas fajit të personit që i ka shkaktuar, shpërblimi dhe shpenzimet e nevojshme të mbrojtësit ose të përfaqësuesit të autorizuar, rregulloret për shpenzimet, kërkesat pasurore juridike, personat e autorizuar për paraqitjen e propozimit për realizimin e kërkesës pasurore juridike, paraqitja, tërheqja dhe heqja dorë nga propozimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike, shqyrtimi dhe vendimi mbi propozimin për realizimin e kërkesës pasurore juridike, anulimi i

pasurore juridike, masat e përkohshëm për sigurimin e kërkesë pasurore juridike, kthimi i pasurisë të dëmtuarit dhe masat për sigurimin e përkohshëm të kërkesës pasurore juridike të drejtuar kundër personave të tretë.

**Kohëzgjatja: Një (1) sesion trajnues apo 3 orë trajnimi.**

### 9.3.10 Procedura sipas mjeteve juridike

Duke qenë se Kodi i Procedurës Penale trajton mjetet juridike të rregullta dhe të jashtëzakonshme, e meqë nën moduli ndërtohet për gjyqtarët fillestar konsiderojmë se mjetet e rregullta juridike do të trajtohen esencialisht në këtë nën modul ndërsa mjetet e jashtëzakonshme do të trajtohen vetëm kur ndërlidhen me vendime që gjyqtarëve fillestar ju duhet në raport me punën e tyre.

Fokusi do të jetë tek ankesa përkatësisht kundërshtimi në procedurën penale. Gjithashtu do të trajtohen po ashtu elementet përmbajtjesore të mjeteve juridike në përputhje me dispozitata e procedurës penale për të ditur me saktësi nga aspekti praktik gjyqtarët se mjetet e tilla juridike çka duhet të përmbajnë në esencën e tyre por duke pasur për bazë edhe formën pasi që aspekti procedural në esencë kërkon edhe aspektin formal.

Qasja në këtë nën modul do të jetë e ndërtuar në vështrim të kategorizimeve themelore të mjeteve juridike dhe atë, në Ankese dhe Kundërshtim, bazat ligjore dhe shkaqet e ngritjes së këtyre mjeteve, mënyrat e vendosjes dhe kush ka kompetencë për të vendosur.

Me këtë nën modul do të synohet që të eliminohen dilemat duke vënë në dukje përmbajtjen e vendimeve dhe aktgjykimeve që potencialisht kanë bazë për tu goditur, pra duke gërshetuar aspektin praktik të aktgjykimeve apo aktvendimeve dhe mjetet juridike ku potencialisht do ta godisnin vendimin e tillë gjyqësor. Do ti ipet rëndësi disa aspekteve të kompetencës për të vendosur, siç mundë të jetë baza nga neni 98 paragrafi 5 i Kodit të Procedurës Penale, që në një farë forme krijon ambiguitet të kompetencave, po ashtu do të interpretohet baza ligjore e goditjes së aktvendimeve kur me aktvendim pretendohet se janë cenuar të drejtat kushtetuese, pra çfarë kategorizimi të të drejtave duhet të konsiderohen, pastaj kuptimin e afateve të ndryshme për ankesë ndaj aktvendimit. Do të adresohen edhe disa aspekte të dilemave që lidhen me mjetet e jashtëzakonshme juridike, e për të cilat duhet vendosur gjykata e shkallës së parë referuar nenit 434. Do të synohet që të adresohen dilemat, lidhur me vendosjen e kolegjit shqyrtues apo nga paneli i hetimit dhe vëzhgimit, përkatësisht nga gjykata e shkallës së dytë. Ky nën modul do të adresoj: Mjetet e rregullta juridike dhe baza ankimore për ushtrimin e ankesës dhe mjete e jashtëzakonshëm juridike.

**Kohëzgjatja: 2 sesione trajnuese apo 6 orë trajnim.**

### 9.3.11 Aktgjykimi dhe llojet e tij

Në këtë nën modul do të synohet që gjyqtarët e sapo emëruar të kuptojnë rolin dhe rëndësinë e një aktgjykimi mbi standardet e kërkuara të Kodit të Procedurës Penal. Do të sqarohet se cilat janë llojet e aktgjykimit, cilat janë pjesët përmbajtjesore të aktgjykimit dhe aspektet teknike. Po ashtu rëndësi të veçantë do të ketë ndërtimi i aktgjykimit varësisht nga lloji i tij që të ketë një strukturë të qëndrueshme dhe të qartë për çdo person e posaçërisht rëndësia që në aktgjykim të përfshihen aspektet materiale dhe procedurale të çështjes penale si dhe të jetë i kuptueshëm dhe me rrjedhë logjike e kronologjike. Ky nën modul do të adresoj specifikat e aktgjykimit dënues, aktgjykimin lirues dhe aktgjykimin refuzues dhe bazat ligjore të mbështetjes së këtyre llojeve të aktgjykimeve.

Qasja në këtë nën modul do të jetë e ndërtuar në atë formë që gjyqtarët e sapo emëruar të jenë të gatshëm që në momentin e fillimit të punës si gjyqtarë të ndërtojnë aktgjykimin me të gjitha

pjesët e tij, e kjo do të arrihet duke u mbështetur në dispozitat procedurale dhe në depozitat materiale ku do të arrihet të bëhet mbi bazën e rasteve praktike. Fokusi do të qëndroj tek aspekti i pjesës së dispozitivit duke qenë në dijeni të faktit se ka shumë aktgjykime në praktikë që kanë të meta themelore në pjesën me përmbajtjesore të aktgjykimit, e që është diapozitivi i aktgjykimit. Po ashtu do të trajtohen aspektet e përmbajtjes së arsyetimit në raport me pjesën dispozitive me qëllim që të përmbushet kërkesa ligjore për përmbajtjen e aktgjykimit dhe njëkohësisht që ti ipet përgjigje brenda aktgjykimit pretendimeve të palëve në proces, mënyrës së zgjidhjeve ligjore që duhet të ketë gjetur rasti. Në këtë nën modul do të trajtohet aktgjykimi dënues, aktgjykimi lirues me te gjitha nën bazat ligjore dhe aktgjykimi refuzues me të gjitha nën bazat ligjore

**Kohëzgjatja: 3 sesione trajnimi apo 9 orë trajnimi**

### 9.3.12 Procedura penale e kryerësve me çrregullime mendore

Procedura penale kur përfshihen kryerësit me çrregullime mendore, paraqet një procedurë të veçantë e sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës. Kjo procedurë e veçantë penale, zbatohet në rastet kur kryerësi i veprave penale në kohën e kryerjes ka vuajtur nga çrregullimet mendore të karakterit të përhershëm apo të përkohshme, të cilat kanë rezultuar me zvogëlimin esencial të aftësisë së tij mendore, apo të paaftësisë së plotë (papërgjegjësisë).

Gjithashtu, ky lloji i procedurës aplikohet edhe në rastet kur te kryerësi i veprës penale, çrregullimet mendore, sëmundjet mendore të përkohshme ose të përhershme janë paraqitur gjatë zhvillimit të procedurës penale apo gjatë gjykimit. Me rëndësi të ceket se sikur te procedura e rregullt penale edhe te kjo procedurë e veçantë patjetër që duhet të aplikohen parimet e përgjithshme të drejtësisë të cilat janë të garantuara edhe me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës. Me një fjalë, kjo procedurë penale dallon prej procedurës së rregullt nga përmbajtja e saj, mënyra e inicimit të procedurës penale, zhvillimi i procedurës, përfundimi i saj si dhe vendimet përfundimtare gjyqësore. Andaj, në ky nën modul do të fokusohet tek: Ekzaminimi psikiatrik, paaftësia mendore dhe aftësia e zvogëluar, aktvendimi për paaftësinë për t'iu nënshtruar gjykimit, paraburgimi për personat me çrregullime mendore, lloji i masave të trajtimit të detyruara, procedura penale dhe shqiptimi i masave te trajtimit te detyruara, dhe monitorimi i zbatimit i masave të trajtimit psikiatrik.

**Kohëzgjatja: 3 sesione trajnuese apo (9 orë trajnimi).**

### 9.3.13 Procedurat e veçanta sipas KPPK

Procedurat e veçanta sipas Kodit të Procedurës Penale dallojnë nga procedurat e rregullta në procedurën penale, prandaj si të tilla kërkojnë një vëmendje shtesë për profesionistët që aplikojnë këto procedura, veçanërisht për gjyqtarët e sapoemëruar. Ky modul do të trajtoj procedurat ndaj personave të cilët kanë kryer veprat penale nën ndikimin e alkoolit ose drogë, urdhër ndëshkimore dhe vërejtja gjyqësore dhe procedura për revokimin e dënimeve alternative dhe procedura për shlyrjen e dënimit nga evidenca.

**Kohëzgjatja: 3 sesione trajnuese (12 orë trajnimi).**

### 9.3.14 Provat në procedurën penale

Procesi i të provuarit zë vendin qendrorë në procedurën penale. Ky proces në vete vet ngërthen një varg çështjes të cilat pastaj e determinojnë gjithë çështjen penale dhe esencën e saj. Gjatë procedurës penale, palët mund të paraqesin provat e tyre, të cilat gjykata në një proces të hapur

dhe transparent i administron ato ku nëpërmes tyre synohet të vërtetohen faktet kontestues me rendësi vendimtare nga të cilat varet edhe përfundimi i një çështje konkrete. Në parim, palët kanë të drejtë që deri në një fazë të caktuar të procedurës të paraqesin provat e tyre para gjykatës, me qëllim të vërtetimit të fakteve që ato vlerësojnë se janë më rendësi për procesin. Përveç palëve edhe gjykata mund të nxjerr dhe shqyrtoj provat sipas detyrës zyrtare apo me propozim të palëve deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor. Në këtë trajnim në fokus do të jenë procesi i të provuarit, provat dhe lloji i tyre, mjetet provuese, marrja e provës në procedurë paraprake si dhe rregullat e përgjithshme për administrimin dhe vlerësimin e provueshmërisë, ligjshmërisë dhe pranueshmërisë së tyre. Përmbajtja këtij nën moduli do të qendroj tek: Burimi i provës, klasifikimi i provave; marrja dhe sigurimi i provave, ligjshmëria e provave, dhe pranueshmeria e provave.

**Kohëzgjatja: 4 sesione trajnues apo 12 orë trajnimi.**

### 9.3.15 Procedurat alternative

Në kapitullin e XIV të KPP-së, janë rregulluar disa nga procedurat alternative të zgjidhjes të çështjeve penale. Në këto procedura është e rregulluar aspekti i veprimit me rastin e aplikimit të këtyre procedurave alternative, kurse karakteristikë e tyre është se mbështetet në parimin e oportunitetit dhe përjashton parimin e legalitetit.

Procedurat alternative janë të rëndësishme për faktin se janë të parapara me legjislacionin bashkëkohor dhe me rastin e zgjidhjes së tyre u mundësojnë palëve në procedurë të jenë të kyçura drejtpërdrejt në aplikimin e tyre dhe në këtë mënyrë eviton procedurat e stërzgjatura përmes procedurës së rregullt gjyqësore.

Trajtimi i kësaj teme për gjyqtarët fillestar do të jetë mjaft i dobishëm gjatë punës së tyre, meqë përmes aplikimit të procedurave alternative do të rritet produktiviteti i performacës së tyre e gjithashtu do të jetë i dobishëm për palët në procedurë me qëllim të zgjidhjes së rasteve të tyre në kohë sa më të shpejtë të mundshme. Ndonëse kyçja e gjyqtarëve në procedurat alternative është në stadet më të vonshme, megjithatë gjyqtarët kanë një rol të rëndësishëm përkitazi me marrjen e vendimeve përfundimtare përkitazi me marrëveshjet e palëve në procedurë dhe i cili rol do të trajtohet përmes sesioneve trajnuese që janë planifikuar të mbahen. Fokus i veçantë i trajnimit do të jetë rëndësia e aplikimit të procedurave alternative dhe roli i gjyqtarit në aplikimin e procedurës së ndërmjetësimit dhe marrëveshjes për pranimin e fajësisë.

Në këtë nën modul do të trajtohet rëndësia e procedurave alternative dhe aplikimi i tyre roli i gjyqtarit në procedimin e rasteve në procedurat alternative, ndërmjetësimi dhe marrëveshja për pranimin e fajësisë në prizmin e gjyqtarit dhe diversioni.

**Kohëzgjatja: 6 (gjashtë) sesione trajnuese ( 18 orë trajnimi).**

## 9.4 E drejta civile, administrative dhe ekonomike

### 9.4.1 E drejta civile

Nën moduli “ E Drejta Civile” është dizajnuar në mënyrë të tillë që përfshinë trajtimin në mënyrë bashkëkohore të parimeve të së drejtës civile në përgjithësi, si bazë për të gjitha pjesët tjera të së drejtës civile. Në këtë kuptim, këtij nën moduli i është dhënë rendësi e veçantë sepse përveç parime të së drejtës civile si bazë për të gjitha pjesët tjera të së drejtës civile, trajton edhe burimet e së drejtës civile; marrëdhëniet juridiko-civile; klasifikimin e të drejtave subjektive civile; punët juridike dhe modifikimin e tyre; përfaqësimin dhe pavlefshmërinë e punëve juridike. Temat e përfshira në këtë nën modul janë bazë për vlerësimin dhe interpretimin e situatave juridike nga çfarëdo pjesë e të drejtës civile dhe ndihmojnë gjyqtarët



e sapo emëruar që të kenë vlerësime profesionale për interpretimin dhe zbatimin e të drejtës objektive në çdo rast që do të jetë objekt shqyrtimi në gjykatë. Ky nën modul adreson në mënyrë të përmbledhur të gjitha çështjet bazë që nuk janë të përfshira për tu trajtuara në nën modulet tjera nga e Drejta Civile, por duke u siguruar që ndërlihdja e nën moduleve në kuadër të së Drejtës Civile të jetë në harmoni të plotë me secilin nën modul dhe duke shërbyer si bazë e secilit nën modul. Të gjitha nën modulet nga e Drejta Civile janë një tërësi e harmonishme dhe unike, duke plotësuar kështu e të gjitha degëve të së drejtës civile. Nën moduli është dizajnuar që të zhvillohet në një ambient interaktiv të diskutimeve në mënyrë që drejtpërdrejtë të ri konsolidohen njohurit mbi principet bazë të së drejtës civile. Një pjesë e rëndësishme e adresimit të sfidave është edhe përballja e pjesëmarrësve me detyra/ shembuj raste praktike ku përfshihen edhe gjendja faktike e rastit duke kërkuar prezantimin e pikëpamjeve të tyre një proces analitik për themelin faktik dhe juridike të çështjes. Në këtë nën modul do të trajtohet: Parimet dhe burimet e së drejtës civile, marrëdhëniet juridiko civile dhe klasifikimi i të drejtave subjektive civile, punët juridike, modifikimi i tyre dhe ndarja e punëve juridike, dhe përfaqësimi dhe pavlefshmëria e punëve juridike.

**Kohëzgjatja: Katër sesione trajnuese (12 orë trajnuese).**

#### 9.4.2 Procedura Kontestimore - pjesa e parë

Procedura Civile është pjesë e të drejtës pozitive dhe si e tillë përfshinë të gjitha rregullat juridike sipas të cilave bëhet mbrojtja dhe realizmi i të drejtave subjektive civile lidhur me marrëdhëniet juridiko-civile. Në këtë kuptim në kuadër të programit fillestar procedura civile, respektivisht nën modulet për procedurën civile, janë pjesë e rëndësishme e kurikulës për zhvillimin dhe ngritjen e kapaciteteve dhe në përgjithësi shkathtësive gjykues të gjyqtarëve të rinj. Ky nën modul është dizajnuar që të paraqes mënyrën se si duhet të zbatohen dispozita e Ligjit për Procedurën Kontestimore në praktikën gjyqësore. Pra, pjesë e rëndësishme janë rastet praktike të cila mbështetën nga një praktikë e mirëfilltë dhe unike gjyqësore. Ky nën modul prezantohet duke referuar vazhdimisht në praktikën gjyqësor lidhur me sfidat e zbatimit unik të Ligjit për Procedurën Kontestimore, si garancion i ligjshmërisë së procesit gjyqësor dhe avancimit të standardeve për gjykim të drejtë dhe në kohë të arsyeshme. Nën moduli është dizajnuar që të zhvillohet në një ambient interaktiv të diskutimeve dhe ushtrimeve praktike, po ashtu përfshinë edhe dy sesione të veçanta për praktikën gjyqësore dhe nënkupton që trajnuesi duhet të paraqes praktikën e përzgjedhur për të gjitha çështjet e diskutuara me parë, në saje të hulumtim të kujdesshëm dhe të mbështetur më material përkatës nga praktika e gjykatave të nivelit me të lartë. Nën moduli do të trajtoj: Parimet e procedurës kontestimore, shqyrtime të përgjithshme lidhur me kompetencën, shqyrtime të përgjithshme lidhur me kompetencën, përbërja e rregullt e gjykatës dhe përjashtimi i gjyqtarit, palët në procedurën kontestimore, parashtrirat dhe dërgimi i shkresave, seancat, afatet dhe kthimi në gjendjen e mëparshme, përfundimi i procedurës me vendim të gjykatës, llojet e aktgjykimeve sipas LPK-së, mjetet e rregullta të goditjes, mjetet e jashtëzakonshme të goditjes, dhe praktika gjyqësore për çështje nga procedura kontestimore.

**Kohëzgjatja: 12 (dymbëdhjetë) sesione trajnuese (30 orë trajnimi)**

#### 9.4.3 Procedura kontestimore - pjesa e dytë

Nën moduli procedura civile – pjesa e dytë është pjesë e rëndësishme e kurikulës për zhvillimin dhe ngritjen e kapaciteteve dhe në përgjithësi shkathtësive gjykues të gjyqtarëve të rinj. Procedura kontestimore – pjesa e dytë, përmban dispozita ligjore që rregullojnë çështjet e rrjedhës se procedurës në gjykatën e shkallës së parë dhe atë duke filluar prej paraqitjes së padisë në gjykatë, bashkëndërgjyqësisë, pjesëmarrja e personit të tretë në kontest - procedurë,

seanca përgatitore dhe pajtimi gjyqësore, seanca për shqyrtim kryesor etj. Ky nën modul prezantohet duke referuar vazhdimisht në praktikën gjyqësor lidhur me sfidat e zbatimit unik të Ligjit për Procedurën Kontestimore, si garancion i ligjshmërisë së procesit gjyqësor dhe avancimit të standardeve për gjykim të drejtë dhe në kohë të arsyeshme. Pjesë e rëndësishme e adresimit të sfidave është edhe përballja individuale e pjesëmarrësve me detyra/ shembuj (raste praktike ku përfshihen edhe gjendja faktike e rastit) duke kërkuar prezantimin e pikëpamjeve të tyre në një proces analitik për themelin faktik dhe juridike të çështjes. Temat të cilat do të trajtohen në kuadër të këtij nën moduli janë: Paraqitja e padisë në gjykatën e shkallës së parë, shqyrtimi paraprak i padisë dhe përgjigja në padi, bashkëndërgjyqësia dhe pjesëmarrja e personave të tretë në gjykim, seanca përgatitore dhe pajtimi gjyqësor, seanca për shqyrtim kryesor, mjetet provuese dhe marrja e provës, dëshmitaret, ekspertet dhe palët, sigurimi i kërkesëpadisë, ndërprerja dhe pushimi i procedurës kontestimore, procedurat e posaçme kontestimore, si dhe dy simulime gjykimi të seancës përgatitore dhe shqyrtimit kryesor.

**Kohëzgjatja: 12 (dymbëdhjetë) sesione trajnuese (36 orë trajnimi).**

#### 9.4.4 Procedura jokontestimore

Procedura Jokontestimore është pjesë e të drejtës pozitive dhe si e tillë përfshinë të gjitha rregullat juridike me të cilat rregullohet struktura e procedurës jokontestimore, pozita dhe roli i subjekteve në procedurën jokontestimore, aktivitetet procedurale të tyre si dhe raportet reciproke në mes tyre. Ndërlidhja e procedurë jokontestimore me procedurën kontestimore është e madhe nga shkak se procedura jokontestimore shfrytëzon dispozita e procedurës kontestimore por gjithashtu udhëzon që në disa raste çështjet nga procedura jokontestimore të kalohen/inicohen në procedurën kontestimore. Në këtë logjik nën moduli i procedurës jokontestimore është pjesë e një tërësi që e përbën procedurën civile dhe si e tillë paraqitë si përmbajtje e domosdoshme për programin fillestar. Përveç kësaj Procedura Jokontestimore, përmban lloje të shumta të procedurave si nga ata statusore po ashtu edhe nga ato pasurore dhe rrjedhimisht përmban edhe shumë specifika të cilat janë adresuar në kuadër të këtij nën moduli. Ky nën modul është dizajnuar që të paraqes mënyrën se si duhet të zbatohen dispozita e Ligjit për Procedurën Jokontestimore në praktikën, pjese të rëndësishme zënë rastet praktike të cila mbështetën nga një praktikë e mirëfilltë dhe unike e procedurës jonkontestimore. Nën moduli në përmbajtje të tij do të përfshije: Dispozitat e përgjithshme të Ligjit të Procedurës Jokontestimore, rregullimi i gjendjeve personale dhe familjare, rregullimi i marrëdhënieve pasurore, hartimi i vendimit ne procedurën jokontestimore, dhe mjetet juridike.

**Kohëzgjatja: 4 (katër) sesione trajnuese (12 orë trajnimi).**

#### 9.4.5 Procedura përbarimore

Procedura përbaruese është procedura që garanton zbatimin e dhunshëm të përbarimit sipas vendimeve gjyqësore dhe titujve tjerë ekzekutiv, prandaj numri i raste të përbarimit është jashtëzakonisht i madh që në vetvete e justifikon nevojën e përfshirjes se këtij nën moduli në kurrikulën e programit fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar. Nën moduli përmban çështjet ma thelbësore të procedurës se përbarimit si për raste kur procedura fillohet tek përbaruesi privat ashtu edhe për raste kur procedura fillohet tek gjykata, pa përfshirja edhe çështjet që lidhen me zbatimin e përbarimit si dhe procedurën sipas mjeteve të goditjes. Ky nën modul është dizajnuar që të paraqes mënyrën se si duhet të zbatohen dispozita e Ligjit për Procedurën Përbarimore në praktikën, prandaj pjese e rëndësishme e këtij nën moduli janë raste praktike të cila mbështetën nga një praktikë e mirëfilltë dhe unike përbarimore. Nën moduli “Procedura Përbarimore” prezantohet duke referuar vazhdimisht në praktikë lidhur me sfidat

e zbatimit unik të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, si garancion i ligjshmërisë së procesit përmbartues për të drejtat e kreditorëve dhe mbrojtjen e debitorit ndaj veprimeve të gabueshme për zbatimin e përmbartimit. Ky modul është dizajnuar që të zhvillohet në një ambient interaktiv të diskutimeve dhe ushtrimeve praktike.

Nën moduli do të trajtoj: Fillimi i procedurës së përmbartimit, kompetenca dhe vendimet e organit përmbartues, bazat juridike për caktimin e përmbartimit, rastet e përmbartimit kur gjykata vepron si organ përmbartues, mjetet, objekti dhe zbatimi i përmbartimit dhe mjetet juridike në procedurën përmbartimore.

**Kohëzgjatja: 5 (sesione) sesione trajnuese ( 15 orë trajnimi).**

#### 9.4.6 E drejta administrative

Në këtë modul do të përfshihet Procedura e Përgjithshme Administrative si dhe Procedura në Konfliktin Administrativ të cilat veç e veç, nënkuptojnë:

E drejta e procedurës administrative përkufizohet si tërësi dispozitash me të cilat rregullohet veprimtaria e organeve administrative, organeve tjera shtetërore dhe organizatave që ushtrojnë autorizime publike, kur në çështje administrative drejtpërdrejtë duke i zbatuar dispozitat, vendosin mbi të drejtat dhe detyrimet e individëve apo të personave juridik dhe palëve tjera. Nga kjo rezulton se këto dispozita rregullojnë formën e veprimtarisë së organeve administrative lidhur me nxjerrjen e akteve administrative.

Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përmban jo vetëm parimet themelore por edhe institutet juridike dhe rregulla juridike procedurale të cilat sigurojnë ligjshmërinë dhe objektivitetin e punës dhe të vendosjes, mbrojtjen e të drejtave subjektive të palëve si dhe inspiron racionalizimin dhe ekonomizimin e procedurës dhe njëherit pengojnë arbitraritetin e organit administrativ që zhvillon këtë procedurë.

Konfliktin Administrativ - është një procedurë gjyqësore e cila udhëhiqet nga gjyqësori duke përfshirë tre shkallëshmërinë në gjykata, dhe në të njëjtën kohë përpos shqyrtimit të ligjshmërisë së vendimeve të organeve administrative të cilën procedure e zhvillon përmes padive të cilat ushtrohen nga palët e pakënaqura kundër një vendimi përfundimtar në procedurë administrative në të njëjtën kohë është një procedure e cila shërben edhe si instrument për kontroll të punës së organeve administrative gjatë vendosjes lidhur me kërkesat e palëve me rastin e shqyrtimit të kërkesës e deri te marrja e vendimit ku në këtë procedure edhe vlerësohet ligjshmëria e akteve administrative, e që edhe i jep rëndësinë e institucionit të veçantë Konflikti Administrativ, si garancion në realizimin e të drejtave dhe interesave të qytetarëve në një procedurë të veçantë dhe nga një organ i pavarur gjyqësor dhe procedurë gjyqësore.

Në këtë modul do të trajtohen të gjitha dilemat që ne si gjyqtar kemi hasur gjatë punës sonë shumë vjeçare në rastet e zgjidhura në praktik, sikurse ato që kanë të bëjnë me procedurën e përgjithshme administrative e cila zhvillohet para organit administrativ ashtu edhe me procedurën e cila zhvillohet në gjykatë në konflikt administrativ, gjithashtu do të shqyrtohet e mundësisht do të sqarohet edhe çdo dilemë e ngritur nga gjyqtarët gjatë mbajtjes së sesioneve trajnuese.

Ky modul në përmbajtje të tij do të trajtoj: fillimi i procedimit administrativ deri në nxjerrjen e aktit administrativ, akti administrativ dhe mjetet juridike, Inicimi i konfliktit administrativ, procedura paraprake në konfliktin administrativ dhe seanca e shqyrtimit kryesor, aktgjykimi dhe mjetet juridike në konfliktin administrativ.

**Kohëzgjatja: 5 (pesë) sesione trajnuese (15 orë trajnimi).**

#### 9.4.7 E drejta e detyrimeve

Këtij nën moduli i është dhënë rëndësia e duhur për shkak të vëllimit të madh të marrëdhënieve juridike civile që janë objekt i normimit me Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve, por edhe për shkak se në praktikën gjyqësore sipas statistikave një numër relativisht i madh i rasteve gjyqësore janë pikërisht nga kjo fushë. Temat e përfshira në këtë nën modul i referohen burimeve materiale të së drejtës së detyrimeve si bazë për krijimin e raporteve juridike civile kontraktuale dhe jokontraktuale, si dhe efekteve juridike, gjegjësisht pasojave juridike që derivojnë nga këto raporte juridike civile.

Ky nën modul adreson në mënyrë të përmbledhur të gjitha çështjet bazë që janë të përfshira/normuar në Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve, duke i kushtuar kujdes të veçantë praktikës gjyqësore që ekziston për raste të cilat mund ta kenë si bazë Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Prezantimi i temave do të bëhet përmes paraqitjes së një apo disa rasteve praktike të ndërlidhura drejtpërdrejtë me temën që duhet të trajtohet në sesionin përkatës. Për parashtrimin e rastit trajnuesi duhet të marrë në konsideratë aspektet faktike dhe juridike të rastit, të parashtrij disa pyetje/dilema mbi të cilat do të zhvillohet diskutimi dhe do të konsumohet tema. Në këtë nën modul trajtohen: Parimet, karakteristikat dhe klasifikimi i detyrimeve, kontrata si burimi i detyrimeve, shuarja e kontratave, shkaktimi i dëmit si burim i detyrimeve, shpërblimi i dëmit, pasurimi pa bazë, gjerimi i punëve të huaja pa porosi dhe shprehja e njëanshme e vullnetit, parashkrimi, mjete reale dhe personale për sigurimin e ekzekutimit të kërkesave, kontrata me fajde, dëmtimi përtej mase dhe kamata, kontrata mbi mbajtjen e përvetshme dhe kontrata e dhuratës, kontrata mbi shitjen dhe kontrata mbi qiranë, dhe cedimi i kontratës dhe cedimi i kërkesës.

**Kohëzgjatja: 12 (dymbëdhjetë) sesione apo 36 orë trajnimi.**

#### 9.4.8 E drejta komerciale

Ky nën modul shtjellon përmbajtjen e lëndës “E drejta ekonomike” e cila përfshinë kryesisht atë që njihet si e drejtë tregtare, përfshirë edhe pozitën juridike të subjekteve ekonomike. Kjo është një degë komplekse juridike, që merret me pozitën juridike të subjekteve ekonomike dhe me afarizmin e tyre juridik në treg. Nevoja e Kosovës për zhvillim të shpejtë dhe të qëndrueshëm ekonomik ka paraqitur nevojën për angazhim të shtuar për rregullimin ligjor të kësaj fushe, andaj Institucione e Republikës së Kosovës në koordinim me palë të interesuara dhe Institucionet relevante ndërkombëtare kanë ndërmarrë një sërë masash drejt zhvillimit dhe implementimit të një legjislacioni ekonomik që mundëson një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Përkundër miratimit të legjislacionit adekuat, implementimi i këtij legjislacioni paraqet sfidë, si për ndërmarrjet dhe afaristët, ashtu edhe për praktikuesit e e profesioneve juridike dhe sistemin gjyqësor. Në vazhden e këtyre përpjekjeve të vazhdueshme, në Kosovë tanimë aplikohen një sërë ligjesh tregtare dhe ekonomike. Por, përveç këtyre ligjeve që janë në fuqi e që janë të publikuara në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në të drejtën ekonomike zbatohen edhe instrumente ndërkombëtare siç janë: Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi Kontratat për Shitjen Ndërkombëtare të Mallrave (CISG), Konventa e New York e vitit 1958 për Njohjen dhe Zbatimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit, Konventa e Parisit për mbrojtjen e pronësisë industriale (20 mars 1883) – organizata botërore e pronësisë industriale, Marrëveshja trips (organizata botërore e tregtisë) si dhe instrumente tjera ndërkombëtare për të cilat, juristet që merren me këtë fushë duhet të kenë njohuri të mjaftueshme. Moduli E Drejta Ekonomike ka për qëllim të ndihmoj gjyqtarët në ngritjen e kapaciteteve të tyre profesionale në lëmin e të drejtës ekonomike. Ky modul do zhvillohet përmes metodave interaktive me qëllim të përfshirjes sa më të madhe të pjesëmarrësve në mënyrë që drejtpërdrejtë të ndihmohet në zbatimin praktik të njohurive ligjore dhe në zhvillimin e aftësive analitike tek gjyqtarët. Përveç udhëzimeve teorike që do të ofrohen në përgjithësi, në sesione të veçanta do diskutohen edhe rastet praktike për të kuptuar specifikat e rasteve të ndërlidhura dhe mënyrat e zgjidhjes së tyre. Ky nën modul do të trajtoj: shoqëritë

tregtare, kontratat në ekonomi, punët bankare dhe siguruese, kontrata e kredisë, kontrata e sigurimit – kompensimi i demit dhe regresimi, kontrata e ndërtimit, efektet e shkëputjes së kontratës, te drejtat e pronësisë intelektuale – të drejtat e autorit & markat tregtare, falimentimi dhe zgjidhja alternative e kontesteve – arbitrazhi.

**Kohëzgjatja: 9 (nëntë) sesione trajnimi apo 27 orë trajnim.**

#### 9.4.9 E drejta e pronësisë dhe të drejtat tjera të sendore

Çështjet pronësore në vendin tonë janë një fushë komplekse dhe tërheqin pas tyre një gamë të gjerë problematikash, që variojnë nga sfidat ligjore dhe ato të praktikës gjyqësore, deri tek përballja e gjykatave me këto çështje. Rëndësia e marrëdhënieve pronësore për qytetarët dhe për shtetin, si dhe kompleksiteti dhe sfidat që paraqet kjo fushë, bëjnë që ky nën-modul të trajtohet me seriozitet dhe thellësi në kurrikulën e programit fillestar të arsimit juridik. Kuptimi i të drejtave pronësore dhe praktikave gjyqësore në lidhje me to është qenësor, sidomos duke marrë parasysh që e drejta e pronës është një nga të drejtat themelore të njeriut sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe KEDNJ. Vendimet e gjykatave në këtë fushë kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në respektimin e të drejtave të njeriut dhe në ruajtjen e paqes sociale. Nën-moduli përfshin një praktikë gjyqësore që është thelbësore për të qartësuar jo vetëm konceptet mbi institucionet qendrore të të drejtave pronësore, por edhe për të kuptuar më thellësisht mënyrat e veprimit të gjyqtarëve dhe për të analizuar praktikën gjyqësore ekzistuese në lidhje me çështjet e paqarta, dilemat apo mangësitë ligjore. Ky nën-modul trajton çështje si e drejta e pronësisë, bashkëpronësia dhe pronësia e përbashkët, mënyrat e fitimit të drejtës së pronësisë (si fitimi derivativ dhe origjiner), mbrojtja gjyqësore e të drejtës së pronësisë, të drejtat sendore në sendet e huaja, vërtetimi, konstituimi dhe ndërprerja e servituteve sendore, mbrojtja e servituteve sendore, posedimi dhe mbrojtja e posedimit, pengu, hipoteka, parablerja, barra sendore, dhe e drejta e ndërtimit (Superficies). Ky modul është projektuar për të zhvilluar një ambient interaktiv, që përfshin diskutime dhe ushtrime praktike, për të ndihmuar gjyqtarët të kuptojnë dhe analizojnë këto tema komplekse dhe të rëndësishme të të drejtës pronësore.

**Kohëzgjatja: 7 (shtatë) sesione trajnues apo 21 orë trajnimi.**

#### 9.4.10 E drejta e trashëgimisë

Nën moduli “E Drejta Trashëgimore” përfshihen çështjet ma thelbësore në kuadër të së drejtës trashëgimore e cila përfshinë tërësinë e dispozitave ligjore me të cilat rregullohen marrëdhëniet trashëgimore që kanë të bëjnë me kalimin e pasurisë nga trashëgimlënësi të persona të tjerë që quhen trashëgimtarë. Në vitin 2019, ka pasuar disa ndryshime në Ligji për Trashëgimin lidhur me kompetencën e organit për ta shqyrtuar trashëgimin, mirëpo në të njëjtën kohë praktika gjyqësore ka njohur zhvillimin e saj në trajtimin e rasteve nga marrëdhëniet trashëgimore e të cilat do të trajtohen edhe në kuadër të këtij nën moduli.

Çështjet trashëgimore kanë kompleksitetin e tyre edhe si procedurë për ta shqyrtuar trashëgiminë por edhe si e drejtë e cila përballët me mohimin e saj në jetën e përditshme. Pasojat juridike të problematikave në marrëdhëniet trashëgimore në shumë raste duhet të përcaktohen me vendim gjyqësor, për çka nevojitet përkushtim dhe profesionalizëm në nivelit të larët për tu trajtuar nga gjykata, prandaj ky nën modul ka rendësin e vet si pjesë e kurrikulës së programit fillestar.

Moduli do të shërbej si bazë e mirë e ofrimit të njohurive për gjyqtarë e rinj të cilët në punë e tyre do të përballën me çështje të ndryshme nga marrëdhëniet trashëgimore, gjithashtu mbështet në konceptet ligjore të rregullimit të së drejtës trashëgimore duke u pasuruar edhe me

standardet e praktikës gjyqësore për çështje të kësaj natyre të cilat janë jashtëzakonisht të rëndësishme lidhur me raste e mohimit të trashëgimisë, cenimit të pjesës së domosdoshme, etj. Temat e përfshira në këtë nën modul janë një përzgjedhje e kujdesshme e çështjeve më të rëndësishme dhe më aktuale. Praktika gjyqësore e cila duhet të jetë pjesë e këtij nën moduli është një burim i pazëvendësueshëm jo vete për të qartësuar mënyrën e zbatimit të dispozitave ligjore por edhe për të njohur standardet e zhvilluar në këtë fushë.

Ky nën modul do të trajtoj: Trashëgimia në bazë të ligjit dhe radhët trashëgimore, trashëgimia në bazë të testamentit, pjesa e domosdoshme, cenimi i pjesës së domosdoshme, padenjési dhe përjashtimi nga trashëgimia, dhe kalimi i pasurisë trashëgimore te trashëgimtarët.

**Kohëzgjatja: 4 (katër) sesione trajnuese apo 12 orë trajnimi.**

#### 9.4.11 E drejta e punës

Marrëdhëniet e punës kanë njohur zhvillime dhe ndryshime të shumta si në aspektin ligjor por edhe të praktikës gjyqësore, ndërsa numri i rasteve gjyqësore është jashtëzakonisht i lartë gjë që dikton nevojën që ky nën modul të jetë pjesë e kurrikulës në programin fillestar. Moduli do të shërbej si bazë e mirë e ofrimit të njohurive për gjyqtarët e rinj të cilët në punë e tyre do të përballën me çështje të ndryshme nga marrëdhëniet e punës. Ky modul mbështet në konceptet ligjore të rregullimit të marrëdhënieve të punës duke u pasuruar edhe me standardet e praktikës gjyqësore për çështje të kësaj natyre. Ky nën modul adreson në mënyrë të përmbledhur të gjitha çështjet bazë që janë të përfshira/normuar në Ligjin e Punës dhe Ligjin për Shërbyesit Civil si dhe disa çështje nga mbrojtja dhe kompensimi i dëmit në punë, gjithashtu do të fokusohet edhe tek çështja e kompetencës për mbrojtje gjyqësore duke e pasura parasysh se i punësuar është shërbyes civil apo i punësuar në bazë të ligjit të punës. Praktika gjyqësore e cila duhet të jetë pjesë e këtij nën moduli është një burim i pazëvendësueshëm jo vetëm për të qartësuar mënyrën e zbatimit të dispozitave ligjore por edhe për të njohur standardet e zhvilluar në këtë fushë.

Në përmbajtje të tij ky nën modul do të përfshijë: Themelimin e marrëdhënies së punës (Ligji i punës –LP, dhe Ligji për shërbimin civil LSHC), kontestet nga marrëdhënia e punës sipas Ligjit të Punës, kontestet nga marrëdhënia e punës sipas Ligjit për Shërbyesit Civil, mbrojtja në punë, dhe kompensimi i dëmit i shkaktuar në punë.

**Kohëzgjatja: 5 (pesë) sesione apo (15 orë trajnim).**

#### 9.4.12 E drejta familjare

E drejta familjare si tërësi është rregulluar me Ligjin e Familjes, i cili në vitin 2019, ka pasuar disa ndryshime lidhur me mënyrën e llogaritjes së kontributit të bashkëshortëve, mirëpo në të njëjtën kohë praktika gjyqësore ka njohur zhvillimin e saj në trajtimin e rasteve nga marrëdhëniet martesore dhe familjare e të cilat janë trajtuara edhe në kuadër të këtij nën moduli.

Çështjet familje zakonisht janë sensitive dhe kërkojnë përkushtim dhe profesionalizëm të nivelit të lartë për tu trajtuar nga gjykata, prandaj ky nën modul ka rendësin e vet si pjesë e kurrikules së programit fillestar.

Moduli do të shërbej si bazë e mirë e ofrimit të njohurive për gjyqtarët e rinj të cilët në punë e tyre do të përballën me çështje të ndryshme nga marrëdhëniet martesore dhe familjare.

Në kuadër të këtij nën moduli trajtohet edhe çështja e dhunës në familje me tërë kompelsitetit dhe specificitetin e saj si çështje me rendësi dhe kujdes të veçantë. Praktika gjyqësore e cila duhet të jetë pjesë e këtij nën moduli është një burim i pazëvendësueshëm jo vete për të qartësuar mënyrën e zbatimit të dispozitave ligjore por edhe për të njohur standardet e zhvilluar në këtë fushë. Adresimi i secilës çështje/temë të përmbledhur në këtë nën modul

duhet të bëhet edhe përmes një prezantimi të shkurtës (teorik) të nocioneve dhe kuptimeve tjera të secilës çështje të ngritur dhe njëkohësisht duhet të pasohet me shembuj për secilën temë/çështje. Shembjet duhet të jenë të përzgjedhur me kujdes dhe duhet të kenë mbështetje në një praktikë gjyqësore të konsoliduar. Ky nën modul do të trajtoj: E drejta familjare, burimet e të drejtës familjare, gjinia dhe llojet e gjinisë, e drejta martesore, zgjidhja e martesës, procedura e shkurorëzimit, detyrimi për ushqim dhe e drejta prindërore, format e veçanta të mbrojtjes së fëmijëve pa kujdes prindëror, kundërshtimi dhe vërtetimi i amësisë apo i atësisë, marrëdhëniet pasurore në mes bashkëshortëve.

**Kohëzgjatja: 5 (pesë) sesione apo ( 15 orë trajnimi).**

## 9.5 Shkathtësitë personale dhe ndërdisiplinare

### 9.5.1 Ngritja e shkathtësive sociale dhe menaxhimi i stresit

Nevoja për një kompletim cilësor të gjyqtarëve të rinj, ka rezultuar me futjen në programin e trajnimit fillestar edhe nën moduleve me karakter interdisiplinar përmes të cilëve gjyqtarët e sapo emëruar do të kenë mundësi të njihen me nocione e kategori, përmbajtje e informacione tjera të rëndësishme nga fusha sociale e psikologjike. Ky nën modul ka për qëllim ngritjen e shkathtësive sociale të gjyqtarëve dhe pajisjen e tyre me njohuri themelore psiko-sociale, komponentë kjo e rëndësishme e kompletimit të një gjyqtari bashkëkohor i cili krahas vëllimit të njohurive dhe eksperiencave profesionale nga lëmia e drejtësisë, me këto njohuri, informata dhe eksperiencia të reja nga fusha sociale psikologjike avancohet për një performacës më cilësore gjatë ushtrimit të detyrës shumë të rëndësishme e tejet delikate. Posaçërisht do të trajtohet menaxhimi i kohës si predispozitë e menaxhimit të stresit nga ana e gjyqtarëve, mbrojtja e shëndetit dhe përmirësimi i cilësisë së punës dhe jetës së gjyqtarëve si dhe rregullat e brendshme të komunikimit, komunikimi me palë dhe me publikun nga ana e gjyqtarëve.

Menaxhimi i kohës është një predispozitë thelbësore për menaxhimin e stresit tek gjyqtarët, një grup profesionistësh që shpesh përballen me presione të larta dhe afate të ngushta. Duke përdorur teknika efikase të menaxhimit të kohës, si përcaktimi i prioriteteve, planifikimi i detyrave dhe delegimi i përgjegjësive, gjyqtarët mund të reduktojnë ndjeshëm ngarkesën e tyre të punës dhe të kontrollojnë më mirë flukset e tyre të detyrave. Kjo jo vetëm që ndihmon në parandalimin e ndjenjës së mbingarkesës dhe stresit, por gjithashtu siguron një qasje më të balancuar dhe të qëndrueshme në vendimmarrje, duke rritur efikasitetin dhe duke përmirësuar cilësinë e punës së tyre. Praktikant e menaxhimit të kohës janë thelbësore për të mbajtur ekuilibrin mes punës dhe jetës personale, një faktor kyç në ruajtjen e shëndetit mendor dhe mirëqenies së gjyqtarëve. Mbrojtja e shëndetit dhe përmirësimi i cilësisë së punës dhe jetës së gjyqtarëve janë thelbësore për funksionimin e drejtë dhe efikas të sistemit të drejtësisë. Kjo përfshin sigurimin e një mjedisi pune të shëndetshëm, të cilësisë së lartë, ku stresi menaxhohet në mënyrë efikase dhe ku respektohen nevojat për ekuilibrin mes punës dhe jetës personale. Përfshirja e programeve për zhvillim profesional dhe edukim vazhdues, janë kyçe për të mbështetur gjyqtarët në detyrat e tyre të përditshme. Më tej, krijimi i një kulture organizative që promovon mirëqenien dhe një balancë të shëndetshme punë-jetë do të kontribuojë në përmirësimin e performancës së tyre profesionale dhe cilësisë së vendimeve që ata marrin.

Ky nën modul trajton tema si: Individit dhe mjedisi social, konfliktet, ngritja e shkathtësive sociale predispozite e avancimit të performacës profesionale, motivimi, stresi dhe shëndeti trupor, psikologjia sociale dhe kriminaliteti, burimet psikosociale të kriminalitetit, dhe kriminaliteti si dukuri sociale.

**Kohëzgjatja: Katër (4) sesione trajnuese apo 12 orë trajnimi.**

### 9.5.2 Etika Profesionale dhe përgjegjësia disiplinore

Nga një gjyqtar pritet që të mbrojë vlera të rëndësishme kushtetuese drejtë krijimit të një mjedisi institucional i cili do të përmirësojë besueshmërinë e qytetarëve në sistemin gjyqësor të Kosovës. Në këtë kuptim nën modulën “Etika Profesionale” është pjesë e rëndësishme e programit fillestar dhe synon që të gjyqtarët e rijnë të ngritë nivelin e kujdesit ndaj sjelljeve që mund ta dëmtojnë imazhin e figurës së gjyqtarit dhe në tërësi integritetin e gjyqësorit.

Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Gjyqtarë i miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, është menduar të jetë një zotim për profesionalizëm e jo plan për ndëshkim. Kodi po ashtu shërben si një njohje (pranim) i përgjegjësive të madhe që e shoqëron shërbimin publik në sistemin gjyqësor të Kosovës. Respektimi me përpikëri i Kodit të Etikës është demonstrim i nivelit më të lartë të profesionalizmit. Kjo është veçanërisht e vërtetë në vendet si Kosova, ku Kodi i Etikës pasqyron parimet themelore të të drejtave qytetare. Nëse një gjyqtarë i kupton qëllimet dhe kushtet e kodit të etikës, ajo njohuri do t'i ndihmojë atij që të shmang rreziqet disiplinore, në të kundërtën gjyqtarët mund të përballën me procedura disiplinore.

Nën modulin “Etika Profesionale” prezantohet duke referuar vazhdimisht në praktikën e krijuar lidhur me zbatimin e Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Gjyqtarë, si garancion për procese gjyqësore objektive, profesionale dhe të besueshme dhe poashtu garancion për integritetin e tërësishëm të sistemit gjyqësor. Bazë e rëndësishme e këtij nën moduli janë edhe konceptet trajnuese të ndërtuara në vite dhe ekspertiza ndërkombëtare që ekziston lidhur me etikën në përgjithësi. Ky modul është dizajnuar që të zhvillohet në një ambient interaktiv të diskutimeve dhe ushtrimeve praktike. Trajnuesi duhet të jetë i përgatitur dhe i hapur për të diskutuar rastin/rastet e ndërlidhur me temën e sesionit përkatës duke nxitur diskutimin interaktiv dhe analitike të çështjes përkatëse, por duke ofruar njëkohësisht perspektivën e ndërtuar ndër vite lidhur me Etiken Profesionale. Një pjesë e rëndësishme e adresimit të sfidave është edhe përballja individuale e pjesëmarrësve me detyra/ shembuj (raste praktike ku përfshihen edhe gjendja faktike e rastit) duke kërkuar prezantimin e pikëpamjeve lidhur me dilemat etike që mund të ekzistojnë. Përmbajtja: Kodi i Etikës profesionale për gjyqtarë, parimet e Kodit të Etikës profesionale për Gjyqtarë, përgjegjësia disiplinore- shkeljet dhe masat disiplinore, dhe procedura disiplinore për gjyqtarët.

**Kohëzgjatja: Katër (4) sesione trajnues apo 12 orë trajnimi.**

### 9.5.3 Menaxhimi i rasteve dhe vlerësimi i Performancës

Menaxhimi është proces i planifikuar i aktiviteteve për arritjen e qëllimeve të caktuara në lëmi përkatëse. Nga ky definicion i thjesht shihet se sa është i rëndësishëm ky proces për gjykatat në tërësi dhe për gjyqtarët në veçanti. Gjykatat ekzistojnë për të ofruar zgjidhje të drejtë dhe të shpejtë për palët në procedurë. Prandaj, funksioni më qendrorë i gjykatës është menaxhimi i rasteve që i kanë. Teoria moderne për menaxhim të rasteve është që gjyqtarët, s’bashku me stafin mbështetës, duhet që në mënyrë aktive të monitorojnë dhe kontrollojnë lëvizjen e lëndëve të pakryera në gjykatë.

Për tu qasur dhe adresuar këto dilemat në praktikë, gjyqtarët e sapo emëruar, përveç prezantimit të materialeve, bashkëbisedimit, prezantimit të rasteve nga praktika gjyqësore po ashtu do të ndahen në grupe për të diskutuar për rastet hipotetike duke shprehur mendimet për zgjidhjen e tyre në praktikë. Në këtë nën modul do të trajtohet: Rëndësia dhe parimet e menaxhimit të rrjedhës së lëndës, qëllimi i punës së gjykatave dhe metodat themelore në menaxhimin e lëndëve si dhe kontrolli i shtyrjes, udhëheqësi dhe masat e Performancës në gjykatës dhe vlerësimi i Performancës së gjyqtarëve dhe Komisionit për vlerësimin e Performancës së gjyqtarëve.

**Kohëzgjatja: 3 sesione trajnimi (9 orë trajnimi)**



### 9.5.4 Rregullat e Komunikimit

Komunikimi në përgjithësi është shkathtësi dhe atribut ontologjik e etiko - social i qenjeve njerëzore. Zhvillimi i hovshëm shoqëror-ekonomik, tekniko teknologjik është përcjellur edhe me standardizime në komunikim herë duke i ruajtur finesat nacionale, etnike kulturale e subkultura e herë- herë duke i sinkronizuar ato në standardizime të institucionalizuar në fusha përkatëse, e sidomos në fushën e teknologjisë e informatikës dhe në fushën juridike. Profesionit i juristit e sidomos ai i gjyqtarit si të ne në Kosovë, ashtu edhe më gjerë kërkon po ashtu si profesionet tjera, një zhvillim të komunikimit cilësor, delikat e konsekuent normativ e profesional brenda vet institucionit të gjykatës si dhe jashtë institucionit me strukturat tjera institucionale dhe opinionin publik në përgjithësi. Përveç përgatitjes profesionale të mjaftuar kualifikuese, edukimi dhe përgatitja e gjyqtarëve bashkëkohor sot nënkupton edhe trajnimin e tyre dhe zhvillimin e shkathtësive komunikuese. Ky nën modul do fokusohet tek shkathtësitë komunikuese brenda rregullave të brendshme, pra zhvillimi i shkathtësive për komunikim të brendshëm duke i mësuar e përvetësuar rregullat e brendshme të komunikimit brenda vet institucionit të gjykatës në vijën vertikale subordinuese dhe atë horizontale bashkëpunuese dhe zhvillimi i shkathtësive për komunikim me jashtë, përkatësisht komunikim me struktura, institucione tjera si dhe opinionin publik në tërësi. Ky modul do të trajtoj: Baza e komunikimit, dhe llojet e tij, veçoritë e komunikimit verbal dhe jo verbal, dallimet dhe lidhjet midis komunikimit verbal dhe jo verbal, komunikimi interpersonal, personal dhe apersonal, të dëgjuarit dhe të folurit, shkathtësia e dëgjimit aktiv, problemet në komunikimin interpersonal dhe rregullat e komunikimit të mirë. Rregullat e brendshme të komunikimit, si dhe komunikimi me palët dhe me publikun, janë pjesë integrale e rolit të gjyqtarëve në sistemin e drejtësisë. Në nivelin e brendshëm, gjyqtarët duhet të ndjekin protokolle të qarta komunikimi që respektojnë konfidencialitetin dhe integritetin e çështjeve gjyqësore.

**Kohëzgjatja: 2 (dy) sesione trajnuese apo 6 orë trajnimi.**

### 9.5.4 Arsytimi i vendimeve gjyqësore ( në lëmin penale dhe civile)

Arsytimi i vendimeve gjyqësore paraqet një prej çështjeve më të rëndësishme të vendim marrjes gjyqësore, përmes të cilës gjyqtarët japin argumentet në mënyrë të përmbledhur se pse pikërisht kanë vendosur në mënyrën e caktuar, ndaj disa opsioneve alternative. Përveç aspektit metodologjik, arsyetimi i vendimit gjyqësor paraqet edhe obligim ligjor, kushtetues dhe aspekt relevant i të drejtës për një gjykim të drejtë të përcaktuar në nenin 6 të KEDNJ-së. Jurisprudenca e vazhdueshme e GJEDNJ-së pasqyron një parim lidhur me mirë administrimin e drejtësisë, se vendimet gjyqësore duhet të tregojnë në mënyrë të mjaftueshme arsytet mbi të cilat ato bazohen (Papon k. Francës). Arsytimi i vendimeve ka për qëllim që t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar dhe, në këtë mënyrë, të japë ndihmesë për të bërë vendimin më të pranueshëm nga ana e tyre. Përveç kësaj, ai e detyron gjyqtarin që të mbështesë arsyetimin e tij në argumente objektive dhe i ruan të drejtat e mbrojtjes. Sidoqoftë, shtrirja e detyrës për arsyetim të vendimit mund të ndryshojë në varësi të natyrës së këtij të fundit dhe duhet të analizohet në dritën e rrethanave të çështjes (Ruiz Torija k. Spanjës, § 29).

Në kuadër të këtij moduli do të trajtohen rregullat dhe metodologjitë se si duhet shkruar një vendim gjyqësor, si duhet argumentuar dhe analizuar në mënyrën e duhur etj. Shpjegimi i mjaftueshëm i standardeve mbi të drejtën për një vendim gjyqësor të arsyetuar, dhe obligimin e gjykatave për të dhënë arsytet e mjaftueshme dhe thelbësore për vendimin. Struktura e vendimeve gjyqësore, dhe metodologjitë e hartimit të vendimeve gjyqësore, shpjegimi dhe aplikimi i metodave të shkrimit ligjor IRAC dhe TREAC, do të dekonstruktohen dhe të përshatzen në praktikën tonë gjyqësore, të inkorporohen në arsyetimin e vendimeve dhe duke e ngritur dhe fuqizuar komponentën analitike të vendimeve, duke i bërë të mjaftueshme

aspektin e identifikimi të problemit, shpjegimit të normës ligjore analizën dhe përfundimet nga një proces logjik dhe strukturor i të shkruarit ligjor.

Dilema themelore e gjyqtarëve të sapo emëruar është se si të hartojnë vendim gjyqësor të strukturuar, i rregullte në përmbajtje, i qartë në kuptim dhe i cili nuk përmban shkelje procedurale dhe materiale mbi të cilat mund të atakohet. Shkrimi dhe arsyetimi i vendimeve gjyqësore paraqet standard të vlerësimi të punës së gjyqtarëve. Në këtë kuptim shkrimi dhe arsyetimi ligjori në punë e gjyqtarëve përfaqëson një objektiv jo lehet të arritshme, prandaj përmes këtij moduli synohet që zhvillohet kapaciteti i gjyqtarëve dhe të ngritët cilësia e arsyetimit dhe shkrimit ligjore në punën e gjyqtarëve të rinj.

Kuptimi dhe zbatimi praktik i metodave ligjore të shkruarit të njohura si IRAC dhe TREAC, është çështje substanciale për avancimin e shkrimit ligjor në përgjithësi në vend, për të ndërtuar standarde të vendimeve të cilat do të ngritin cilësinë e arsyetimit dhe rrjedhimisht edhe të vendimeve gjyqësore në përgjithësi. Qasja është që përdorimi i këtyre metodologjive të shkrimit ligjor të kaloj në një praktikë të zakonshme, dhe të përditshme të punës së gjyqtarëve në draftimin e vendimeve gjyqësore. Në këtë aspekt, që të përgatiten për përdorim efektiv të tyre do të ketë shembuj praktikë të zbatimit në praktikën gjyqësore gjatë sesioneve trajnuese. Zhvillimi i shkathësive analitike tek gjyqtarët e rinj është një nder sfidat e programit fillestar e cila diktohet nga nevojat e praktikës gjyqësore. Ky modul do të trajtoj: Të drejtën për vendim të arsyetuar gjyqësor, parimet e shkrimit Ligjor, metodologjia e Përdorimit të Formulës IRAC dhe TREAC, struktura dhe metodologjia e hartimit të aktgjykimit penal dhe civil.

**Kohëzgjatja: 8 (tetë) sesione trajnuese apo 24 orë trajnim.**

## 9.6 Legjislacioni dhe shkathësitë plotësuese

### 9.6.1 Kodi i Drejtësisë për të Mitur

Kodi i Drejtësisë për të mitur ka hyrë në fuqi në prill të viti 2019 (KDM), sikurse edhe Kodi paraprak, rregullon pjesën e përgjithshme, procedurën ndaj të miturit, gjykimin madhoreve për veprat penale të kryera ndaj fëmijëve, mbrojtjen e fëmijëve si dëshmitar dhe të dëmtuar me vepër penale si dhe ekzekutimin e sanksioneve ndaj të miturit.

KDM përmban dispozita në të cilat janë të inkuorporuara parimet e Konventës Evropiane për të Drejtën e Fëmijës dhe me çdo ndryshim, ka risi te cilat i përcjellin ndryshimet ne standardet më të avancuara ndërkombëtare. Kësaj radhe, është shtuar kapitulli për mbrojtjen e fëmijëve si dëshmitar dhe të dëmtuar me vepër penale.

Interesi me i mirë i të miturit është parim më i rëndësishëm i KDM i shprehur jo vetëm në dispozitën e veçantë, por edhe në shumë dispozita tjera si në pjesën e përgjithshme ashtu edhe në pjesën e procedurës penale ndaj të miturit, ndërsa interesi me i mirë i fëmijës viktime është parim mbizotërues në kapitullin e mbrojtjes se fëmijëve si dëshmitar dhe të dëmtuar me vepër penale.

KDM është i gërshetuar me parime tjera të procedurës ndaj të miturit, siç janë urgjenca e procedurës, konfidencialiteti i saj, mbrojtja profesionale e obliguar në çdo fazë të procedurës, moshja e përgjegjësie penale, masat dhe dënimet e veçanta, gjyqtar dhe prokurore të specializuar për të mitur, mundësia e ndryshimit të vendimit dhe mosekzekutimi eventual i masës, aplikimi i parimit të oportunitetit në ndjekje penale e shumë të tjera, të cilat garantojnë procedurën e shpejte, të drejtë dhe fer ndaj ekzekutorit të mitur të veprës penale.

Adresimi i dilemave në praktikë që janë me rëndësi për gjyqtarët e sapo emëruar nga tematika e përmendur do të bëhet përmes shpjegimit të pjesshëm teorik, të nocioneve themelore që përmban Kodi i Drejtësisë për të Mitur dhe aplikimi i tyre konkret përmes rasteve nga praktika gjyqësore nacionale. Gjithashtu adresimi do të bëhet edhe përmes interpretimit të dispozitave të Konventës Evropiane për të Drejtat e Fëmijës.

Nën moduli në përbërje të tij do të ketë: Parimet udhëzuese, përkufizimet, masat dhe dënimet ndaj të miturve dhe zgjedhja e tyre, shqiptimi i masave dhe dënimeve madhorëve për veprat penale të kryera si të mitur efekti i dënimit në masën edukuese, masat e diversitetit dhe ndërmjetësimi, masat edukuese dhe dënimet, procedura përgatitore, shqyrtimi gjyqësor, vendimet dhe mjetet juridike, dhe mbrojtja e fëmijës si viktime në procedurën penale.

**Kohëzgjatja: 6 sesione trajnuese apo 18 orë trajnimi.**

### 9.6.2 Ndërmjetësimi në çështje civile

Ndërmjetësimi është veprimtari jashtëgjyqësore që realizohet nga një person i tretë (ndërmjetësi) për zgjidhje të mosmarrëveshjeve ndërmjet subjekteve të së drejtës në pajtim me kushtet e parashikuara me ligj. Zbatimi i ndërmjetësimit në trajtimin e mosmarrëveshjeve në çështjet civile përbënë një alternativ konstruktive jashtëgjyqësore për arritjen e një zgjidhje të kënaqshme për palët e përfshira në mosmarrëveshje, ku përpos që është zgjidhje alternative me ndryshimet legjislative është përcaktuar edhe ndërmjetësimi i detyrueshëm ku gjykata obligon palët që të provojnë zgjidhjen e çështjes me ndërmjetësim.

Përfshirja e ndërmjetësimit si institucion juridik dhe aplikimi i saj në procedurat gjyqësore është një mundësi relevante dhe shumë e rëndësishme në zgjidhjen e shumë lëndëve me të cilat gjykatat janë të stërngarkuara dhe do të arrihej efikasiteti i gjykatave duke u liruar nga lëndët e mundshme për zgjidhje me marrëveshje, kurse gjyqtarët të kenë kohë të mjaftueshme të merren me lëndë me të komplikuar që t'i kryejnë në një afat me të arsyeshëm dhe me kualitative.

**Kohëzgjatja: 1 sesion trajnues (3 orë trajnimi)**

### 9.6.3 Zhvillimi i shkathtësive gjyqësore

Duke pasur parasysh ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale lidhur me marrjen në pyetje dhe udhëheqjen e shqyrtimit gjyqësor është e nevojshme që gjyqtarët e sapoemëruar të trajnohen lidhur me zhvillimin e shkathtësive gjyqësore në përputhje me këto ndryshime. Në mënyrë specifike ngritja e shkathtësive do bëhet për fjalën hyrëse, marrjen e drejtpërdrejtë dhe të tërthorët në pyetje, vënien në dyshim, rehabilitimin dhe fjalën përfundimtare.

**Kohëzgjatja: 6 ditë trajnimi (2 grupe)**

### 9.6.4 Ligji për kundërvajtje

Duke pasur parasysh që vepra e kundërvajtjes është vepër që kryhet në shumë lëmi, rëndësinë e tyre, kohën e kufizuar për trajnim, do të synohet që pjesëmarrësit të njoftohen me veprën e kundërvajtjes, dallimin me veprat e tjera, parimet e veprës dhe përcaktueshmërinë e veprës kundërvajtëse me dispozitat ligjore në fuqi. Pjesëmarrësit gjatë trajnimit do të njoftohen me veprën e kundërvajtjes, çka e dallon nga veprat tjera, dhe cilat janë elementet e përbashkëta me veprat tjera (vepra penale, delikti ekonomik etj.).

Gjithashtu pjesëmarrësit do të njoftohen me parimin e ligjshmërisë, dhe rëndësinë e tij në përkufizimin e veprës së kundërvajtjes.

**Kohëzgjatja: 2 sesione trajnimi apo (6 orë trajnimi)**

### 9.6.5 Mbrojtja nga diskriminimi

Nën moduli “*Mbrojtja nga diskriminimi*” është dizajnuar në mënyrë të tillë që përfshinë trajtimin në mënyrë bashkëkohore të parimeve dhe procedurave për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë. Meqenëse numri i rasteve të iniciuara në gjykatë me bazë mbrojtjen kundër diskriminimit është në rritje e sipër, atëherë kjo edhe e përcakton nevojën e përfshirjes së këtij nën moduli në kurrikulën e programit fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar. Nën moduli përmban çështjet ma thelbësore rreth bazave dhe formave të manifestimit të diskriminimit, llojet e trajtimit të pabarabartë, detyrimet e institucioneve publike në parandalimin dhe trajtimin e rasteve kundër diskriminimit, si dhe procedurat, afatet dhe vendimmarrja nga ana e gjykatës për trajtimin e padive me bazë diskriminimin. Ky nën modul është dizajnuar që të paraqes edhe mënyrën se si duhet të zbatohen dispozita e Ligjit kundër Diskriminimit (LMnD) në praktikë, përmes trajtimit të rasteve praktike, të cila mbështetën në praktikën gjyqësore të gjykatave vendore dhe asaj të GJEDNJ, bazuar në interpretimin e nenit 14 të KEDNJ, për mbrojtje kundër diskriminimit. Nën moduli “*Mbrojtja nga diskriminimi*”, prezantohet duke u referuar vazhdimisht në praktikë, lidhur me sfidat e zbatimit unik të Ligjit për Mbrojtje kundër Diskriminimit, si garancion i ligjshmërisë së procesit për të drejtat e palëve dhe mbrojtjen e tyre ndaj veprimeve diskriminuese. Ky modul është dizajnuar që të zhvillohet në një ambient interaktiv të diskutimeve dhe ushtrimeve praktike.

Nën moduli do të trajtoj: Bazat dhe format e manifestimit të diskriminimit sipas LMnD, Llojet e Trajtimit të Pabarabartë, Përgjegjësitë e Institucioneve të Republikës së Kosovës, Qasja në Institucionin e Avokatit të Popullit dhe procedura para tij, Procedura para gjykatës, Afatet, Barra e Provave, Shqyrtimi i fakteve nga gjykata në lidhje me të provuarit e diskriminimit, llojet e vendimeve dhe mjetet juridike, Shpërblimi i dëmit për shkak të diskriminimit nga marrëdhënia e punës, E Drejta Materiale për Ndalimin e Diskriminimit, Instrumentet Ndërkombëtare të cilat janë të Zbatueshme në Kosovë sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Interpretimi i Nenit 14 i KEDNJ nga Gjednj, Praktika GJEDNJ e aplikueshme sipas nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

**Kohëzgjatja: 2 (dy) sesione trajnuese (6 orë trajnimi).**

### 9.6.6 Dhuna në familje

Çështja e parandalimit të dhunës në familje në të gjitha format e saj, është e rregulluar me Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje nr.03/L-182, i cili ka hyrë në fuqi në muajin Gusht të vitit 2010, duke e shfuqizuar Rregulloren e UNMIK-ut nr.2003/12, për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje. Pavarësisht progresit formal që është bërë në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, fenomenet e caktuara si dhuna në familje, etj, ka vazhduar të mbetet si sfida serioze për shoqërinë dhe mekanizmat/agjencitë që zbatojnë këto ligje, lidhur me parandalimin e dhunës në të gjitha format e saj. Kosova në vitin 2020 me Amandamet Kushtetues ka pranuar si pjesë të sistemit juridik të vendit ton Konventën e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje.

Mbi bazën e kësaj konvente dhe nevojave për reformë në legjislacionin që rregullon këtë fushë, në vitin 2023 është miratuar Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore (Ligji Nr. 08/L-185 21 shtator 2023). Qëllimi i këtij ligji është që të parandalojë dhe trajtojë dhunën ndaj grave, dhunën në familje dhe dhuna në baza gjinore, të mbrojë dhe të kontribuojë në eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit

ndaj grave, promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave si dhe të ndërtojë mekanizmat e nevojshëm për ofrimin e mbështetjes ndaj viktimave të të gjitha formave të dhunës të rregulluara me këtë ligj.

Në modulën me temë “Dhuna në familje” do të shtjellohet kuptimit dhe përkufizimi i dhunës në familje, dhuna ndaj grave, dhunë me bazë gjinore ndaj grave, ngacmimi politik, dhuna politike, dhunë psikologjike, dhuna ekonomike, kontrolli i vazhdueshëm, ngacmimi seksual përmes internetit, sindromi i personit të dhunuar dhe përkufizimin palëve dhe përfaqësuesit për mbrojtjen e interesave të viktimave. Në kuadër të këtij moduli do të trajtohen çështje që kanë të bëjnë me subjektet që kanë të drejtë për të iniciuar procedurën për shqiptimin e masave mbrojtëse, masat mbrojtëse marrë për bazë dhunën në familje, dhunën ndaj gruas dhe formave të tjera të dhunës të rregulluar me këtë ligj, procedura për shqyrtimin e kërkesës për urdhër mbrojtje të rregullt dhe procedura për shqyrtimin e kërkesës për urdhër mbrojtje emergjente. Do të trajtohet roli dhe detyra e institucioneve kompetente për zbatimin e këtij ligji si dhe Udhëzimet administrative, instrumentet ndërkombëtare dhe rajonale që e mbulojnë këtë fushë.

**Kohëzgjatja: 4 (katër) sesione trajnuese (12 orë trajnime)**

## 10. Përfundim

Ky program trajnues reflekton nevojat për trajnim të gjyqtarëve të sapoemëruar dhe pritjet e institucioneve të sistemit gjyqësor dhe prokurorial në përgatitjen dhe zhvillimin e shkathtësive profesionale, etike dhe shkathtësive praktike, me qëllim që në përfundim të tij, këta përfitues të jenë të gatshëm për ushtrimin e plotë të funksionit të gjyqtarit në mënyrë profesionale, të pavarur dhe efikase.

Struktura e programit, modulet trajnuese dhe trajnimi praktik, reflektojnë synimet e përcaktuara të AD-së për zhvillim të kompetencave, duke u mbështetur në kohëzgjatjen e trajnimit të përcaktuar me ligj dhe duke marrë në konsideratë përgatitjen dhe përvojën e kaluar profesionale të përfituesve të cilët tashmë kanë kaluar të gjitha fazat e testimit dhe vlerësimit të kompetencave profesionale nga ana e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, përkatësisht komisioneve përkatëse.

**Akademia e Drejtësisë**  
<https://ad.rks-gov.net>  
[infoad@rks-gov.net](mailto:infoad@rks-gov.net)  
Rr. “Murat Mehmeti” nr.1-3, Prishtinë.  
Tel:+383 38 200 18 660